


BIBLIOTEKA  
SHTETIT

92

e 39.



**ISMAIL** SKENDER  
**JETA**  
**DHE**  
**VEPRA** LUARASI  
**QEMALI**

92  
—  
039.

5.

SKËNDER LUARASI

# ISMAIL QEMALI

(Jeta dhe vepra)

(Botim i dytë)



23191

SHËTËPIA BOTUESE E LIBRIT POLITIK



Ismail Qemali

*«Djemtë e mi, nuk bëra pasuri t'ja lija  
trashëgim Shqipërisë. Po ju lë një atdhe —  
amanet. Lamtumirë!».*

ISMAIL QEMALI

P J E S A I

NË SHËRBIM  
TË PERANDORISË OTOMANE

## H Y R J E

Koha në të cilën lindi dhe jetoi, kultura që fitoi, mërgimi në të cilin shkoi një pjesë të djalërisë i internuar, ofiqet e ndryshme të larta, me të cilat u vesh herë pas here në shërbim të perandorisë otomane dhe personalitetet me të cilat u njoh, bashkëpunoi dhe ra në luftë, liberalizmi i tij i sinqertë kundrejt popujve të sunduar nga Turqia, dashuria për vendin e lindjes dhe për të gjithë popullin shqiptar dhe, mbi të gjitha, kujdesi i tij që t'i shërbente së mirës e lirisë së atdheut të dashur, gjithë këto kushte dhe rrethana i dhanë Ismail Qemalit aftësitë që t'ja arrinte më lehtë qëllimit aq fort të dëshiruar nga populli shqiptar: ngritjes së flamurit kombëtar e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

T'i japësh dcrën një fatkeqi në hallet e tij të veçanta, të shpëtosh një fëmijë nga rreziku në mes të rrugës, të bartësh shokun tënd të plagosur që të mos bjerë në dorë të armikut, është punë e madhe; — po sa më e madhe është ajo punë atëhere kur i jep dorën një populli të tërë në nevojën më të keqe dhe e shpëton nga vuajtjet shekullore dhe i ndihmon të ngrihet e të bëhet i lirë!

Për veprën e tij shumë të vlefshme, Ismail

Qemali u bë njeriu më i luftuari dhe njeriu më i lëvduari në historinë e Rilindjes shqiptare. Armiqtë e Shqipërisë, diplomatë të fuqishëm të shteteve të mëdha, që kanë pasur interes ta bënë vendin tonë plaçkë tregu, sidomos fqinjët lakmitarë të Shqipërisë me mercenarët e tyre të pendës, gjatë historisë së re të popullit shqiptar, kur nuk kanë mundur t'i gllabërojnë viset tona me mjetin e forcës brutale, janë munduar të dalin fitimtarë duke krijuar me anën e shpifjeve një nështypje të rreme në sy të botës për këtë vend e për këtë popull.

A s'janë munduar ta krijojnë këtë nështypje të rreme e ta zënë diellin me shoshë edhe atëhere kur ky diell shqiptar ka ndriçuar me lavdi jo vetëm Shqipërinë po gjithë Evropën? Atdheu ynë i mrekullueshëm ka qenë për turqit e Muratit dhe të Mehmetit II një vend i ashpër, me shtigje të fshehta, i vështirë për hyrje e dalje aq sa, siç thonë, atje nuk ka mundur të depërtojë as Aleksandri i Madh. Populli ynë trim e liridashës për ata nuk ka qenë veçse një «frotë e lindur për të kundërshtuar, për të mos u përlulur e për të mbajtur inat». Dhe Heroi ynë Kombëtar, shembull klasik i trimërisë dhe i atdhedashurisë, nuk ka qenë veçse «një bylykbash ushtarësh të pafe dhe mëkatar që veshi petkun e tradhëtarit».

Më duket interesante të bëhet këtu një krahasim midis jetës së Skënderbeut dhe Ismail Qemalit: edhe Ismail Qemali në fillim të karrierës së tij u prit mirë në rrethet e larta të hierarkisë turke, dhe lufta kundër këtij patrici shqiptar nisi vetëm atëhere kur bota turke pa se biri i shquar i Vlorës mendonte si shqiptar e kurrë nuk do t'i përulej vullnetit tiranik të një sulltani. Për turqit «Ismail Qemal beu është më i zi se Laneti përshkruar prej Muhamedit.

Asnjë turk nuk është më i prapshtë se ai. Ai ja shet vatanin armikut. . .»

Po ja që Ismail Qemali nuk qe turk, po shqiptar i kulluar që çliroi vatanin prej zgjedhës turke dhe të gjitha sharjet, që bëjnë armiqtë e Shqipërisë kundër tij kthehen në lëvdata për të. Dhe populli i tij për këtë vepër të madhe çlirimtare është mirënjohës për jetë ndaj këtij biri të shquar të Shqipërisë.



## FAMILJA

Sipas zakonit të vjetër, në Shqipëri, shumë njerëz në mërgim merrnin emrin e fshatit për llagap, kështu edhe familja e Ismail Qemalit mbante për llagap emrin e qytetit, prej të cilit kishte dalë, Vlora. Themeluesi i familjes Vlora është Sinan Pasha nga Kanina, i cili në shekullin XVI, pasi zuri ofiqin e vezirit të madh, zbriti në Vlorë në kohën e Sulejmanit të Shkëlqyer me cilësinë e një kapedan Pashe, ose kryeadmirali të flotës, dhe banoi në këtë qytet, gjersa vdiq.

Pas pushtimit të Shqipërisë prej turqve dhe veçanërisht pas islamizimit të shumicës së popullit shqiptar, aristokratët përpiqeshin të gjenin tituj fisnikërie për familjet e tyre në lidhje me origjinën orientale, sikundër grekët e vjetër pretendonin se zbritnin nga familje fisnike të Egjiptit. «Por e vërteta është, — thekson Ismail Qemali në «Kujtimet» e tij, — që katragjyshi ynë Sinan Pasha qe shqiptar i kulluar; se gjatë sundimit otoman, me gjithë keqpërdorimin prej anës së sundimtarëve turq, i shërbyen besnikërisht perandorisë, ndërsa në të njëjtën kohë mbajtën të pastër e të papërlyer ndjenjën tonë kombëtare prej shqiptari».

Pasardhësit e Sinan Pashës vazhduan të gëzonin

ofiqe të larta në perandorinë gjatë gjithë historisë së saj të turbullt; patën në dorë sidomos qeverimin e viseve të Beratit e të Vlorës që së bashku formonin njërin nga të tre sanxhakët (prefekturat) e Vilajetit të Janinës. Ky ofiq i trashëguar brez pas brezi vazhdoi gjer në atë kohë kur i famshmi Ali Pashë Tepelena u bë sundimtar fuqplotë i Janinës, dhe ja rrëmbëu Ibrahim Pashës, vëllait të gjyshit të Ismail Qemalit, vendin e qeveritarit në Berat e Vlorë Ibrahim Pashën e burgosën në Janinë, ku vdiq po në atë kohë kur Ali Pasha vetë që rrethuar atje prej ushtrive perandorake.

Është mirë të vihet në dukje se me gjithë padrejtësitë që i punoi Ali Pasha familjes Vlora, Ismail Beu, stërgjyshi i Ismail Qemalit, e shumë nga parësi e vendit muarën pjesë në fushatën kundër armikut të huaj më 1821.

Kur u çlirua prej andrallave të tjera, Reshit Pasha, vezir i madh dhe kryekomandant i ushtrive turke, arriti në Janinë për të vendosur rregullin e për të forcuar sundimin e fortë të sulltanit në Shqipëri. Që të merrte shpagë mbi Ismail Benë, Reshit Pasha e ftoi Ismail Benë në Janinë, duke i dhënë siguri se ishte caktuar kryeqeveritar i Vilajetit. Ismail Beu u nis me një fuqi prej 500 vetash. Me të arritur në Janinë, njerëzit e tij u dërguan menjëherë për të buajtur në shtëpi të ndryshme të qytetit. Ai vetë u grish të vinte te Reshit Pasha që të vishej me nderimet e zyrës së lartë. Shkoi, pra, pa vonesë, kaluar, i shoqëruar nga një shpurë e vogël, drejt pallatit në qytezën e famshme. Sa hyri në oborr, portat u mbyllën prapa tij, dhe pikërisht kur ishte duke zbritur nga kali u vra me gjithë ata pak njerëz që e përcillnin. Kjo ngjau më 1827.

Tafil Buzi, i syrgjynosur në Ysqydar, kur dëgjoë se e vranë Ismail Benë, u dërgoi fjalë lebërve: «Turp për ju! Erdhi halldupi i Konjës në vatrën tuaj, ju vrau vëllanë në Janinë, dhe s'u bë për burrë asnjë nga ju t'i merrte gjakun».

Dhe Gjoleka ju përgjegj:

*«Tafil Buzit të m'i thoni,  
Gjoleka s'e turpëroi,  
Kaftanazin e martoi,  
Me të dyja ç'e qëlloi,  
Nëpër dyzetmijë shkoi».*

Që prej kësaj ngjarjeje Gjoleka kishte qenë lidhur me breza besnikërie të veçantë me familjen e Vlorës.

## FËMINIA

Ismail Qemali lindi më 24 janar të vitit 1844 në Vlorë, në atë qytet ku 68 vjet më vonë do të shpallte pavarësinë e mëmëdheut të tij. Lindi, pra, në një epokë nga më të rëndësishmet në historinë e perandorisë otomane, pjesë e së cilës qe edhe Shqipëria. Sundimi fuqiptotë i Ali Pashës në Janinës qe përmbysur, qe krijuar mbretëria e Greqisë, qe njohur sundimi gjysmëindependent i Mehmet Aliut në Misir; më 1839, si vepër plotësuese e hyrjes së perandorisë otomane në konceptin evropian, u shpall Hati i Sherif i Gjylhanesë që hapi periudhën e reformave të njohura me emrin Tanzimat. Perandoria turke në këtë kohë kishte hyrë në fazën e rënjes dhe të dekompozimit të saj; klasat sunduese, duke parandjerë dobësimin e kalbëzimin e sistemit shoqëror të Turqisë, ndërmuarën një sërë masash për t'i frenuar këto procese, duke zbatuar disa reforma gjysmake me karakter feudoborgjez. Këto reforma ata u përpoqën t'i vënë në jetë edhe në Shqipëri. Kjo është një nga rrethanat shoqërore më të rëndësishme, që lojti rol në formimin e karakterit të Ismail Qemalit, rrethanë e cila la vazhdë në gjithë veprimtarinë e tij.

Qëllimi kryesor i pushtetit turk ishte të themelonte një sistem të centralizuar për së tepërmi. Re-

format, në përgjithësi, kishin karakter gjysmak, dhe jo vetëm nuk kënaqnin nevojat më elementare të fshatarësisë e zejtarëve, po u sillnin këtyre një shtypje ekonomike e pçlitike edhe më të rëndë. Për këtë arsye reformat turke nuk mund të zhduknin hende-kun e madh që ekzistonte midis Portës së Lartë e popujve të nënshtruar. Pra për të evituar konflikte të reja të armatosura, sulltani nuk shpejtoi të zbatonte menjëherë ati i Sherifin e Gjylhanesë në ato vise ku Porta prej kohësh kishte hasur në rezistencë. Ju desh të prishte edhe pesë vjet, gjersa të zbatonte dekretin e ri në Shqipëri (më 1844 në Shkodër, më 1845 në Jug). Këto masa, të cilat e ngarkonin me taksa të rënda dhe me shërbim ushtarak të detyruar popullin shqiptar, të vëna në veprim me forcë dhe fare papandehur, dëmtonin keq sidomos interesat e fshatarëve shqiptarë, të cilët nuk po shpërbleheshin me asnjë të mirë. Pasojat ishin kryengritja e përgjithshme. Ushtritë turke, të dërguara kundër shqiptarëve prej steresë dhe detit, shkelën Shqipërinë dhe u bënë shumë përpjekje, në të cilat ushtritë perandorake u thyen disa herë prej fshatarëve shqiptarë.

Pra pas disfatës së kësaj kryengritjeje të madhe të fshatarëve, turqit arrestun ndër shumë të tjerë edhe babanë e Ismail Qemalit, Mahmud Benë dhe xhaxhanë e tij Selim Pashën, të cilët i burgosën së pari në Manastir, në qendrën e korparmatës së Rumelisë. Më vonë erdhi urdhër të internohej gjithë familja e tij: e ëma Hedije hanëmi (vajzë nga familja Alizoti e Gjirokastrës), i vëllai, e motra, dhe vetë Ismail Qemali, që të tre fëmijë, dhe gjyshja e tyre plakë.

Nisja e tyre, të përcjellë nga 50 kalorës shqiptarë, i ngjiste më fort një udhëtimi për në dasmë

se sa një largimi të dëshpëruar, që nuk dihej se ku dhe si do të mbaronte. Një gjë e mirë për fëmijët, që më fort zbaviteshin se sa trembeshin nga gjithë ky salltanet, ishte se ndalonin në qytetet kryesore: Berat, Elbasan, Ohri, Manastir, ku priteshin e për-cilleshin nga autoritetet e populli me gjithë nderimet për udhëtarë të shquar. Duke ndënjur në çdo qytet me javë e madje me muaj, ata njiheshin me vende dhe njerëz. Pas një qëndrimi dy javësh në Manastir, u larguan nga ky qytet duke i thënë lamtumirë Shqipërisë.

«Ime motër dhe unë, — tregon Ismail Qemali, — me gjithë gëzimin që ndjenim prej udhëtimit e prej bukurive natyrore, që ndryshonin me viset që zhdukeshin, herë-herë pyesnim njëri-tjetrin se ç'ishte shkaku për këtë shtegëtim të gjatë dhe do të mërgoheshim përgjithmonë nga atdheu ynë. Duke shkuar larg e më larg brenda në tokë joshqiptare, ku vetë viset, zakonet, gjuha, dhe çdo gjë që në kontrast të rreptë me ç'ishim mësuar në Shqipëri, na pushtoi një mallëngjim i madh. Helmi na u shtua prej vdekjes së gjyshes në një han, në udhë e sipër, dhe varrimit të saj në Jenixhe. E ndjemë këtë fatkeqësi aq hidhur sa mund ta ndjenin zemrat tona të njoma».

Në Selanik familja ndenji tre vjet e internuar. Nëna e Ismail Qemalit, e re dhe në vend të huaj, që s'ja njihte as gjuhën as zakonet, tregoi zotësi të madhe në drejtimin e jetës së përditshme të familjes. Zuri miqësi me familjet më të njohura të Selanikut, muhamedanë, të krishtere ose çifute, me të cilat njohu edhe familjet e të internuarve elbasanas që rronin afër tyre. Jo vetëm qeveriste shtëpinë, po rregullonte edhe pasurinë e familjes në Vlorë, ku çonte njerëz të besuar, dhe i dërgonte të holla të shoqit

në Konjë. Fëmijtë u mësuan me jetën në Selanik. Një ngjarje vetëm ua helmoi përsëri jetën atje, vdekja e vëllait të vogël, Sulejmanit. «Edhe sot e kësaj dite, sa herë vete në Selanik, gjithnjë e vizitoj varrin e tij të vogël prej mermeri në vorrezat e xhamisë Ortaj», — tregon Ismail Qemali.

## ARËSIMI

Në kohën kur bota shqiptare ndodhej zhytur në robëri dhe padituri, gjyshi më shumë se babai ishte shtylla morale e familjes, përveç nënës. Ndërsa babaj-largohej prej atdheut për të kërkuar mjetet e rroj-tjes në kurbet, a me harxhe, gjyshi, që nga krei i vatrës qeveriste shtëpinë dhe edukonte fëmijtë. I mblidhte fëmijtë rreth e rrotull e u tregonte të gjithëve sa kishte grumbulluar të mirë e të vlefshme në jetën e tij të gjatë. Në një kohë kur nuk ekzistonin shkolla dhe libra, goja e gjyshit bëhej burimi i diturisë për të rinjtë. Prej atij burimi shqiptarët kërthinj mësonin gjuhën e tyre të bukur, folklorin e pasur, zakonet fisnike, trimëritë e stërgjyshërve, dashurinë për atdheun e tyre të bukur, vuajtjet e mëdha të popullit shqiptar, durimin e tij pa kufi, po dhe vendosmërinë shembullore për të ruajtur truallin e të parëve dhe lirinë.

Këtë dobi në arësimin e tij, Ismail Qemali nuk e gëzoi dot prej gjyshit, të cilin ja kishin vlarë 17 vjet përpara se të lindte, por e ëma trime, e zonja dhe e zgjuar, u përpoq t'i jepte të birit një arësim sa më të mirë, që të bëhej «shqiptar i plotë».

Në Selanik Ismail Qemalin e dërguan në shkollë



fillore dhe atje pati rastin e mirë të mësonte turqishten që në fcsnjëri. Pas faljes që u bëri sulltani të internuarve, ai u kthye në Shqipëri, e vazhdoi mësimin e kësaj gjuhe, dhe mësoi italishten nga një refugjat italian. Më shumë se prej të atit Ismail Qemali mori edukatë shqiptare prej s'ëmës, e cila pati kujdes që i biri të bëhej shqiptar i plotë.

Elementet kryesore në edukatën e një djaloshi shqiptar në familjet aristokrate të asaj kohe qenë të rendurit me kalë, të qëlluarit me pushkë dhe të dalët për gjah. «Në çdo stinë më dërgonin të bëja shëtitje me kalë në fshatrat e rrethit të Vlorës, i shoqëruar nga dy tutorët e mi dhe shokë versnikë, dhe me shumë trima pas. Kështu vizitoja fshatrat e ndryshme dhe isha mysafir i familjeve të para dhe kënaqesha me lloj-lloj festash, veçanërisht me shfaqjet e valleve kombëtare që fcrmonin një pjesë të arësimit të rinisë», lexojmë në «Kujtimet» e Ismail Qemalit.

Gjatë Luftës së Krimesë, Ismail Qemali qe dësh-muesi i dy vizitave interesante në konakun e të ungjit, Selim Pashës: i vizitës së kryedukës Maksimiljan që u bë perandor i Meksikut, dhe i vizitës së oficerëve të flotës franceze në lundrim e sipër për në Krime. Përmendim sidomos këtë të dytën për shkak të një episodi që Ismail Qemali dhjetëvjeçar thotë se nuk e harroi tërë jetën e tij: disa rrugaçë që kishin «përvetësuar» disa ushqime të naftëve në qytet, i ungji dha urdhër t'i kapnin dhe t'i rrihnin botërisht. «Të klithurat e tyre aq fort ma lënduan zemrën fëminore, — thotë Ismail Qemali, — sa vrapova tek im ungj, i hodha krahët për qafe dhe ju luta ta pushonte këtë të rrahur».


Këtë kchë i vdiq mëmë-gjyshi; e ëma shkoi në

Janinë për ngushëllim, duke marrë të birin dhjetë-veçar me vete. Aty Ismail Qemali nisi mësimet në gjimnazin Zosimea. Duke qenë i pari dhe i vetmi nxënës shqiptar muhamedan në atë kohë atje, u bë objekt i përfilljeve të veçanta jo vetëm në sy të shkolllarëve po edhe të profesorëve, «Kam kujtimet më të mira për mësuesit e mi, dhe i jam shumë i detyruar kujtimit të Omer Efendiut e të profesorit Tsimas, të cilët më dhanë mësimet të posaçme, njëri në arabishte e tjetri në frëngjishte», — tregon Ismail Qemali. Me diplomën në xhep dhe me një dëftesë të posaçme për mirësjellje, Ismail Qemali u nda nga gjimnazi, pasi mori njohuri të «mësimeve humanitare», të greqishtes së vjetër dhe latinishtes, dhe u pajis me njohuri të shkencave natyrore e të matematikës, për të cilën pati prirje dhe aftësi të veçanta.


Janina dhe shkolla Zosimea janë një rrethanë e rëndësishme në jetën e Ismail Qemalit. Nuk mund të jetë e rastit që një tok eksponentësh të Rilindjes shqiptare muarën edukatën arësimore kryesisht në bankat e Zosimesë, u mbrujtën aty me idetë përparimtare të kohës, sidomos me idealet e iluministëve borgjezë francezë. «Soditja rreth kujtimeve të madhërisë së Francës më ushqeu mendjen që në foshnjërinë time», — tregon Ismail Qemali. Dhe shton: «Qeshë veçanërisht i lumtur që pata për profesorë të literaturës e të Greqisë antike burra nga më të shquarit të asaj kche, që u munduan të më mësojnë auktorët klasikë si mësim, po më bënë të jetoj në këtë atmosferë lirie të botës greke të moçme».

Siç e thamë edhe më lart, në Janinë edhe më parë se të studjonte Ismail Qemali, lëvizja patriotike shqiptare kishte pasur një traditë mjaft të zhvilluar. Idetë iluministe përparimtare dhe patriotizmi u bënë

qysh në këtë kohë ushqimi që e rriti Ismail Qemalin,  
ashtu sikundër ndodhi me Rilindasit e tjerë Jani  
Vreton, Kristoforidhin, Abdylin, Samiun dhe Naim  
Frashërin, të cilët kush më përpara, kush më vonë se  
Ismail Qemali kaluan përmes shkollës Zosimea.



Ismail Qemali i ri



## FILLIMI I KARRIERËS POLITIKE

Në maj të vitit 1860, Ismail Qemali la Janinën dhe pas dhjetë ditësh udhe me kalë arriti në Stamboll, të cilin e pa për të parën herë. Këtu banoi në shtëpi të Mustafa Pashë Gjiritliut, farefis i së ëmës, dhe zuri punë në zyrën e përkthimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Lajmi i vdekjes së motrës së tij e bëri të kthehej në Janinë, ku shërbeu si ndihmësdrejtor i punëve politike gjer më 1864. Këtë vit u martua për të parën herë me një vejushë të re nga Konica, e cila brenda një viti vdiq lehonë së bashku me të bijën. Kësaj kohe, duke shëtitur në qarkun e Janinës, Ismail Qemali zbuloi gjurmat e tempullit të famshëm të Dodonës; këtë zbulim interesant ja bëri të njohur shokut të tij të shkollës, Konstantin Karapanos, dhëndërrit të milionerit Kristaq Zografit nga Qesorati, i cili nisi gërmimet që nxorën në dritë atë thesar të çmuar arkeologjik.

Nga Janina, njëzetvjeçari u nis për te i ungji Ismail Rahmi Pasha, valiu i Thesalisë, i cili e emëroi shef kabineti. Pas një viti u kthye në Stamboll dhe prapë filloi punën në zyrën e përkthimeve të Portës së Lartë. Këtë vit, kur s'ishte veçse një djalë njëzetvjeçar, Ismail Qemali mori pjesë në të parën mbledhje që patriotët shqiptarë Pashko Vasa, Hoxhë Tah-

sini, Koto Hoxhi dhe Kristoforidhi organizuan për të filluar punën e tyre kcmbetare për «shkronja dhe për shkolla shqipe». Po këtë kohë u takua me të atin e rikthyer nga internimi, i cili vdiq në Stamboll më 1866. Ismail Qemali do të emërohej kryesekretar i qeverisë në Janinë, kur Mitat Pasha, guvernator i vilajetit të Danubit, e ftoi në Rustçuk. Në maj të vitit 1866, pra, u nis për në kryeqendrën e Bullgarisë së atëhershme dhe i ndihmoi Mitat Pashës në veprën që kishte nisur ky burrë i madh shteti.

Në Rustçuk, më 1867, Ismail Qemali u martua me gruan e dytë, zonjushën e bukur Kleoniqi Surmeli, bijën e një zotnie grek nga Adrianopoja, me të cilën pati katër vajza dhe gjashtë djem.

Më 1867, Porta e Lartë vendosi formimin e Këshillit të Shtetit. Mitat Pasha pranoi kryesinë e këtij instituti dhe e thirri Ismail Qemalin me cilësinë e një *maitre de requêtes*<sup>1)</sup> i klasës së parë në Këshillin e Shtetit. Por shpejt Mitat Pashën e transferuan vali të Mesopotamisë, dhe Ismail Qemali do të ishte nisur për në Bagdat si kryesekretar i atij vilajeti, kur Ali Pasha, vezir i madh, e gjeti të nevojshme ta dërgonte prefekt në Varnë, duke pasur shef Aqif Pashën, nën të cilin kishte shërbyer në Janinë.

Pikërisht në këtë interval, në vitin 1869, u bë ajo mbledhja e famshme e patriotëve të kolonisë shqiptare në Stamboll, prej së cilës ju shkrua Ali Pashës, vezirit të madh, shkresa me lutjen që t'u jepej leje edhe shqiptarëve të shkruanin libra e të hapnin shkolla në gjuhën amtare. Në këtë mbledhje gjejmë të pranishëm përsëri edhe njëzetepesëvjeçarin Ismail Qemalin, që në mënyrë të ndërgjegjshme e

---

1) Shef i kabinetit.

bëri qëllim të jetës së tij interesimin për çështjen e çlirimit të atdheut. Në fakt në këtë mbledhje nisi të merrte forcë ajo lëvizje shqiptare që shpuri në Lidhjen e Prizrenit, në themelimin e Shoqërisë së Stambollit dhe në lëvizjen e përgjithshme të Rilindjes shqiptare.

Ndërkaq qarqet konservatore në Portën e Lartë filluan të ankoheshin e të kundërshtonin «kursin e butë» të Ali Pashës ndaj çështjes shqiptare si të rrezikshme për unitetin e islamizmit dhe të perandorisë, meqenëse njëhte parimin kombëtar aty ku kishte qenë në fuqi vetëm parimi fetar islamik dhe me këtë u hapte shtegun edhe kërkesave të kombësive të tjera muslimane. Nën presionin e këtyre akuzave të ngritura pranë sulltanit, Ali Pasha filloi t'i nxirrte vështirësi komisionit iniciator. Ismail Qemalin, që kishte qenë një nga pjesëtarët më aktivë, e larguan qëllimisht nga Stambolli. Kështu atë e transferuan në Bullgari larg shokëve të tij të punës dhe në shumë mënyra e penguan duke e ngarkuar me detyra që nuk i përkisnin çlirimit të atdheut tonë.

Puna më e madhe që nisi të bënte Ismail Qemali brenda detyrës së tij zyrtare qe ndërtimi i portit të skelës së Varnës, të skelës më të rëndësishme në Bullgari. Nga Varna, në mars të vitit 1870, Ismail Qemali u dërgua prefekt i Dobruxhasë, me qendër Tulça; në prill shkoi në Galac, ku ishte selia e Komisionit Evropian të Danubit, i emëruar president i këtij komisioni. Që këtu Ismail Qemali tregoi zotësitë e tija si administrator e diplomat duke kapërcyer me aftësi të rrallë gjithë intrigat që zunë t'i përgatisnin kundërshtarët e tij. Përveç punëve botore, të cilave Ismail Qemali u qëndronte personalisht në krye, nisën të hapeshin kudo shkolla të çdo lloji dhe në çdë



fshat. Shumë nga punët e mira që u bënë kësaj kohe në këtë vilajet të Rumelisë i kushtohen energjisë së Ismail Qemalit.

Shqiptarët patriotë edhe më 1871 i filluan rish-tazi përpjekjet për krijimin e një organizate patriotike; dhe përsëri e gjejmë Ismail Qemalin pjesëtar aktiv e të zellshëm në këtë përpjekje fisnike, në të cilën për të parën herë del në dukje dhe Sami Frashëri. Interesant është se në këtë kohë, kur, për të parën herë, u bisedua se cili alfabet të pranohej për të shkruar shqipen, arab, grek apo latin, Ismail Qemali u shpreh në dobi të alfabetit latin.

Në vitin 1873 Ismail Qemali dha dorëheqjen që të merrej me punë private. Pikë së pari vizitoi Vlorën dhe u nis për një shetitje në Romë, Paris e Londër, gjatë së cilës pasuroi njohuritë e tija me studime serioze të institucioneve të ndryshme të Perëndimit, studime që i kishte vazhduar gjatë nëpunësisë së tij edhe në Gallata Saraj të Stambollit. Në Paris bëri marrëveshjen me drejtorinë e Kompanisë Asfaltine për eksploatimin e minierave të bitumit në Selenicë, koncesionin e të cilave e kishte marrë vetë më parë Ismail Qemali. Kur u kthye në Vlorë prej udhëtimit, mori vesh për zbritjen nga froni të Abdyl Azizit dhe hipjen në fron të Muratit V. Viti 1876 shkoi i mbushur me ngjarje rreth dinastisë osmane. Murati V u zbrit nga froni për arësye të çmendurisë së tij dhe në fron hipi Sulltan Abdyl Hamiti, i cili u betua se do të sundonte si monark konstitucional. Po sulltani i ri e ndryshoi tekstin e Hatt-it — që kërkonte konstitucion — pa pyetur vezirin e madh dhe as Mitat Pashën, i cili qe autori i projektit.

Ndërkaq ndodhën trubullira në Rumeli; u bënë kryengritje dhe masakra në Bullgari, lindën vështi-

rësi, prej të cilave nuk e shpëtoi dot Turqinë as shpallja e konstitucionit të përgatitur prej Mitat Pashës, i cili më 1877 u emërua vezir i madh.

Një nga idetë e Mitat Pashës ishte që të krijonte një vilajet të Shqipërisë. E përmendim këtë gjë këtu jo vetëm se na intereson të dimë, por edhe sepse ky mendim u bë një nga shkaqet e grindjes midis sulltanit e vezirit të madh, i cili u pushua dhe, tek po e dërgonin syrgjyn, u arratis. Ismail Qemali në shenjë proteste për masat e rrepta që muarën kundër shefit të tij të adhuruar, dha dorëheqjen nga sekretaria e përgjithshme e Ministrisë së Jashtme, në të cilën ishte emëruar një vit më parë.

## SHTATË VJET SYRGJYN

Pas mërgimit të Mitat Pashës plasi lufta midis Ruisë dhe Turqisë. Në këtë kohë plot trubullira për Turqinë, qeveria i propozoi Ismail Qemalit të prante një vend si anëtar i Komisionit të Luftës; por Ismail Qemali nuk e pranoi këtë vend dhe kërkoi të dërgohej përfaqësues në Athinë ose prefekt në Vlorë. Veziri i madh ju zotua se do të vendoste për njëren nga të dyja këto nëpunësi; porse me të arritur Ismail Qemali në zyrën e tij, i erdhi një oficer nga Ministria e Luftës dhe e lajmëroi që të shkonte në atë dikaster menjëherë.

Ismail Qemali vajti dhe përnjëherësh e përcua llën në paradhomën e gjyqit ushtarak, ku kishin sjellë edhe shumë nëpunës të tjerë. Pasi pritën atje disa orë, erdhi një tjetër oficer që i lajmëroi se me urdhër perandorak do të niseshin pa vonesë për në Brusë. Në Brusë muarën vesh se cilido nga të arrestuarit do të internohej në një fshat të ndryshëm të Anadollit; për Ismail Qemalin qe zgjedhur Kutahia.

Në Kutahi, Ismail Qemalin e veçuan nga çdo marrëveshje me botën e jashtme dhe kështu ndenji i burgosur në një shtëpi për dy muaj, i ruajtur nga një xhandar që rronte po në atë shtëpi. «Kjo burgosja ime qe një nga ato rasat e çuditshme, që rrallë

i takon edhe në Anadoll, në të cilën një i burgosur politik paguan qiranë për burgun e tij dhe mban me harxhet e veta edhe kujdestarin e burgut!> — tregon Ismail Qemali me ironi.

Kjo ngjarje e hidhur na Shtyn të bëjmë dy pyetje: përse vallë tamam në një kohë të tillë, kur Ballkani qe bërë fushë betejash dhe shkaku kryesor i Luftës ruso-turke, Ismail Qemali kërkoi vetë të emërohej ministër i Turqisë në Athinë, ose mytesarif në Vlorë? Dhe përse vallë, kur qe duke pritur emërimin e premtuar papandehur arrestohet dhe syrgjynoset në Anadoll?

Këto dy pyetje nuk mund të mos na bëjnë të mendojmë se Ismail Qemali nuk do të ketë qëndruar krejtësisht i mënjanuar nga detyra patriotike për organizimin e rezistencës kundër planeve të Fuqive të Mëdha që kishin për qëllim copëtimin e Shqipërisë. Për bashkëpunim të drejtpërdrejtë të Ismail Qemalit me organizatorët e Lidhjes së Prizrenit nuk janë gjetur ende fakte, por neve na duket pa vend që t'i mohohet ky bashkëpunim. Këtë e themi jo me hamendje, e mbështetim në disa fakte të tërthorta. Ismail Qemali më shumë se një herë ka shprehur urrejtjen kundër brendisë së Traktatit të Shën Stefanit dhe kundër politikës së Bismarkut dhe Traktatit të Berlinit. Dhe këtë jo pa shkak, Traktati i Shën Stefanit që dënonte me vdekje perandorinë turke dënonte me vdekje bashkë me të edhe Shqipërinë.

Prandaj edhe kërkesa e tij të ndodhej në Athinë ose në Vlorë tregon interesimin e tij të madh për të mos qëndruar pasiv edhe për të ndihmuar vendin e tij gjatë këtyre kohëve të vështira për Shqipërinë. Edhe arrestimi i tij nënkuptohet se nuk ka qenë veçse një provë tjetër që tregon, se megjithëqë Ismail

Qemali nuk ishte me asnjë mënyrë për disfatën e Turqisë në këtë luftë, ai u paraqit i rrezikshëm për sundimtarët turq. Dhe të rrezikshëm në atë kohë për Turqinë ishin ata shqiptarë të cilët nuk donin ta lirin në mëshirën e fatit të ardhmen e Shqipërisë, si patriotët Abdyl Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vretua, Hoxhë Tahsini, Koto Hoxhi, me shumicën e të cilëve, siç dihet fort mirë, Ismail Qemali mbajti miqësi të përhershme dhe të cilët pësuan ndjekje ashtu si edhe ai në atë kohë.

Pas mbarimit të Luftës ruso-turke, u duk sikur u bë një farë pajtimi midis sulltanit dhe Mitat Pashës, me fatin e të cilit që lidhur disi edhe fati i Ismail Qemalit. Mitat Pasha u thirr të kthehej nga Anglia në Turqi dhe një nga jahtet e perandorit e sollë në Kretë ku ju desh të priste urdhërin e fundit të të zot. I emëruar vali i Sirisë, shkoi në Damask. Së këtejmi u transferua përnjëherësh vali në Izmir, qytet që u kuptua si stacioni i fundit për në Stamboll.

«Meqenëse vendi ku isha internuar unë nuk ndodhej larg rezidencës së re të Mitat Pashës, ne hymë në korrespondencë dhe në letrën e tij të fundit më thoshte se do t'i bënte kërkesë formale sulltanit për mua që të më caktonte në personelin e ofiqit të tij», — tregon Ismail Qemali.

Mirëpo pak më vonë Mitat Pasha u arrestua dhe u përcuall në kryeqytet nën roje që të gjykohej si i pandehur për vrasjen e Abdyl Azizit. Arrestimi i Mitat Pashës, i «Babajt të Konstitucionit», dhe i atij burrë shteti të madh e liberal, i ra Ismail Qemalit si një rrufe, dhe e dëshpëroi gjithë popullin. Ndonëse dihej që Abdyl Azizi vrau veten, pasi e zbritën nga fronin, rrethi i sulltanit e krijo këtë intrigë që të

shpëtonte nga frika që i kishte ai këtij burri të madh se mos kthehej edhe një herë në fuqi.

Pas gjyqit e dënimit, Mitat Pasha u syrgjynos në Talif dhe nuk u ekzekutua vetëm nga ndërhyrja e opinionit publik të Perëndimit. Për gjendjen e mikut të tij të madh të burgosur në kalanë e Talifës, Ismail Qemali mori lajme prej Izet Pashës, veliut të Brusës, kur ky erdhi për inspektim në Kutahi. E përmendim këtu Izet Pashën se ky ndërhyri te sulltani për ta shpëtuar Ismail Qemalin prej internimit.

Në vitin 1884 Ismail Qemali u lirua nga internimi. Por ai nuk u pajtua kurrë me sundimtarët turq. E ruajti të pastër e të fortë dashurinë për vendlindjen dhe urrejtjen për ata që e mbanin nën zgjedhë. Dy letra të kësaj kohe na e vërtetojnë këtë. Njëra letër është e Ismail Qemalit që ky ja dërgonte nga Bolui një zyrtari të lartë, të cilit i shprehte mallin që kishte për atdheun dhe i lutej ta ndihmonte që ta emëronin në ndonjë vend sa më afër Shqipërisë. Letra tjetër anonime, e shkruar nga një funksionar i lartë turk, i drejtohej sulltanit, të cilit, duke ju ankuar kundër Ismail Qemalit, nuk linte pa vënë në dukje se Ismail Qemali gjithmonë ishte përpjekur për të keqen e perandorisë dhe interesohej vetëm për dobinë e tij dhe të vendit të tij.

## NË KAFAZIN E FLORINJTË TË SULLTANIT


Në kryeqytet, Ismail Qemali falënderoi sulltanin për lirimin nga internimi dhe vezirin e madh Sait Pashën për emërimin si mytesarif në Mardin (Mesopotami), post të cilin nuk e pranoi «për arësye ekonomike». Atëhere u emërua qeveritar në Bolu, ku arriu në maj të vitit 1884. Këtu, që ditën e dytë, mori vesh vdekjen e Mitat Pashës të internuar në Taif.

Zhdukja e këtij burrë shteti, pas aq vuajtjesh, që një dackë e rëndë për mua, — e nis Ismail Qemali mallëngjimin e tij për Mitat Pashën në «*Kujtimet*». — Humba gjithë shijën për punën dhe gjithë shpresën për të ardhmen e perandorisë, për të cilën ai ka qenë reformator i vërtetë. Për javë të tëra u bëra pre i melankolisë më të thellë. Më pushtoi dëshpërimi për çdo gjë, për të ardhmen, për jetën, për njerëzimin. Kur një njeri kaq i shquar, kaq i zhveshur nga çdo egoizëm dhe interes vetiak, që kishte bërë aq shumë për atdheun e për njerëzimin, mund ta gjenë një fat i këtillë në duar të atyreve, të cilët i detyronin nder e miradi, dhe më në fund arrin një përfundim të tillë tragjik të mjerë, atëhere, pyeta veten: ç'mund të prisnin e të shpresonin të tjerë njerëz?»



Ismail Qemali me nipërit e tij





Dhe e mbaron panegjericën me këto fjalë: «Ndër shumë cilësi të tjera që kishte Mitat Pasha, veprimtaria e tij e palodhur dhe integriteti i papërkulshëm qenë të rralla në orient... Ishte ndoshta i vetmi burim shteti turk që nuk kishte paragjykime kundër kombësive të tjera dhe nuk i dha kurrë privilegje elementit zotëronjës».

Jeta në syrgjyn për shtatë vjet me radhë, në regjimin e Sulltan Hamitit, ndonëse i dha raste Ismail Qemalit të shihte ndryshimin e keq të gjendjes, nuk e kishte lejuar të kuptonte në masën e duhur ndryshimin që kishte ngjarë në vetë qeverinë e vendit. Porse që atë ditë që u kthye në shërbim aktiv dhe mori në dorë administratën e atij qarku, i ra në sy dhe ja dërmoi shpirtin zvetërimi moral që gjeti në gjithë sferat qeveritare.

Sulltani mendonte për të siguruar në gjithë deget e administratës nëpunës të atillë që t'i shërbenin besnikërisht atij pa le t'i thyenin gjithë rregullat e administratës. Funkionarë dhe nëpunës të shtetit nga çdo klasë e shkallë ishin të lirë të bënin ç'të donin vetëm të jepnin prova besnikërie dhe bindjeje ndaj sulltanit. Kudo mbretëronte shpërdorimi, korrupcioni dhe çorganizimi i çdo lloji për të keqen e vendit dhe të banorëve.

Nuk mund të zgjatemi duke dhënë shembuj se si Ismail Qemali vuri rregulla në shërbimin administrativ në qytet e në zyrat qeveritare, duke dhënë shembull se si përfaqësuesit e zgjedhur prej popullit duhej që të bëheshin shërbëtorët e tij.

I lodhur nga veprimtaria e gjerë që zhvilloi në Bolu, erdhi në Stamboll që të jepte dorëheqjen, të hynte në jetën private dhe të merrej me ndonjë punë industriale. Ndër të tjerat Ismail Qemali e ndjeu

për detyrë patriotike të interesohej për ndërtimin e hekurudhës Selanik-Manastir duke u përpjekur që të zgjatej kjo vijë gjer në Vlorë. Por edhe në këtë punë u pengua nga qëllimet egoiste të fuqive të mëdha dhe nuk ju plotësua dëshira.

Ndërkaq, Ismail Qemalin, që ta kishin nën mbikëqyrje zyrtare, e shtrënguan të hynte në administratë e të shkonte prefekt në Galipoli, ku ndenji vetëm dy muaj. Së këtejmi e dërguan vali në Bejrut, ku zhvilloi punë administrative të mëdha dhe të vlefshme. Atje pati gëzimin e madh që piqej përsëri me bashkatdhetarin e tij Pashko Vaso Pashën, me të cilin kishte qenë shok zyre në Komisionin e Filipopolit. Vaso Pasha në atë kohë qe qeveritar i Libanit; po duke qenë i sëmurë, vinte në Bejrut për të dimëruar dhe vdiq atje më 1892, pak më parë se Ismail Qemali të thirrej në Stamboll.

Kur u kthye Ismail Qemali në Stamboll më 1892, sulltani i kërkoi një raport mbi reformat e perandorisë dhe mbi politikën që duhej të ndiqej. Në një memorandum të gjatë Ismail Qemali i përshkruan sulltanit gjendjen e vajtueshme të perandorisë, nevojën e ngutshme për reforma rrënjësore, dhe mënyrën se si të zbatoheshin ato. Po duke qenë se sulltani kishte vendosur të sundonte si autokrat, pikëpamjet përparimtare të Ismail Qemalit ja shtuan më tepër urrejtjen Sulltan Hamitit kundër këshilltarit të tij liberal.

## NËN SHPATËN E DEMOKLEUT

Që kur u kthye nga Bejruti dhe gjer në vitet e fundit të shekullit XIX, Ismail Qemali ndenji në Stamboll. Këta tetë vjet ishin një internim i vërtetë, një burgim, ishin një dënim nën shpatën e Damokleut. Shpeshherë sulltani i kërkonte nga ndonjë raport mbi çështje të rëndësishme. Më i pari është ai mbi gjendjen e Egjiptit dhe mbi politikën që duhej ndjekur për sa i përkiste atij vendi; një i dytë është memorandumimi mbi çështjen e hekurudhave në Azinë e Vogël, një tjetër mbi gjendjen e armenëve; dhe më e fundit është promemoria më datën 24 shkurt 1897, mbi gjendjen e përgjithshme.

Në tre vjetët e fundit marrëdhënjet midis sulltanit dhe Ismail Qemalit qenë si një lodër e maces me minë. Në fillim sulltani e lajmëroi Ismail Qemalin se do ta emëronte qeveritar të përgjithshëm në Kretë, dhe se shpresonte që me zotësinë e tij ky do ta shtronte atë vend që ishte në kryengritje. Nisjen e Ismail Qemalit për në Kretë sulltani e shtyri për shumë muaj gjersa më në fund e hoqi nga defteri.

Një ditë Shambellani i sulltanit e thirri Ismail Qemalin në pallat. «Sa arrita atje, Arif Beu më lajmëroi buzagaz se madhëria e tij kishte vendosur të më jepte postin e ambasadorit në Teheran, dhe

se kërkonte t'i parashtroja me shkrim se do t'i mbeshtesha besnik dhe se do të pushoja të ushqeja ndjenja admirimi për kujtimin e Mitat Pashës», — tregon Ismail Qemali vetë.

Kjo që e para herë që sulltani shfaqte sheshit dyshimet që mbante fshehur për marrëdhënjet e Ismail Qemalit me Mitat Pashën. Ismail Qemali e hodhi poshtë kërkesën e sulltanit dhe i shkroi se vazhdonte të ruante kujtimet më të mira për të ndyerin dhe ju lut sulltanit t'ja linin gjykimin për veprat e të vdekurit, ndërmjetësit suprem të historisë. Edhe emërimin për në Teheran Ismail Qemali nuk e pranoi.

Ngjarjet e hidhura në Sassun e të tjera vise të banuara prej armenëve shërbyen si shkak për Fuqitë e Mëdha të mblidheshin për çështjen e reformave. Këtë kohë Shambellani Arif Beu e thirri Ismail Qemalin dhe i dorëzoi një dokument që përmblihte një sërë reformash për Tripolin (Tarabulluzin), të diktuar prej sulltanit vetë. Të nesërmen mori prej vezirit dekretin, me të cilin Ismail Qemali emërohej vali në Tripoli. Kur gjithë përgatitjet ishin bërë dhe familja e Ismail Qemalit dhe personeli i tij ndodheshin në vapor për t'u nisur, kur gjithë bota zyrtare e pati marrë vesh emërimin, dhe Ismail Qemali vajti në pallat të përshëndetej me sulltanin, perandori i shprehu dëshirën ta mbante edhe më në Stamboll.

Sulltani kishte nevojë për Ismail Qemalin në lidhje me çështjen armene. «Po me gjithë përpjekjet e mia që të pushonin masakrat e tmerrshme, ato vazhduan. Kushdo besonte se s'kishte mbetur farë armeni, por armenët ngulnin këmbë të provonin që ende kishte armenë, dhe vetë unë besoja që sulltan

gjithashtu dëshironte të kishte armenë që të mundte t'i shtypte», — tregonte Ismail Qemali me ironi të hidhur.

Ismail Qemali, që prej vjetve të fundit ishte emëruar në Këshillin e Shtetit, mori urdhër ta pushonte botimin e dyjavores së tij Mexhra-Efkjar («Rrjedhja e ideve»), ndalohej të takohej me personalitete politike të huaja e të pranonte ftesat e tyre për vizita, dhe i viheshin prapa spiunë dhe aventurierë, si Gani Toptani, që ta diskreditonin e ta vrisnin; gjithashtu mori vesh se sulltani pati vendosur ta arrestonte e ta dërgonte në vend të ponjohur. Një ditë e thirrën në pallat dhe e lajmëruan se qe emëruar vali në Tripoli (Tarabulluz), prandaj të pregatitej për t'u nisur. Shpata e Damokleut po i varej mbi kokë.

Në këtë çast tragjik, Ismail Qemali diti të merrte një vendim që qëndronte në lartësinë e karakterit të tij burrnor. Ai vendosi ta braktiste Stambollin e Sulltan Hamitin. Këtë vendim mund ta quajmë si aktin më të lartë në veprimtarinë e tij përpara ngrihtës së flamurit në Vlorë dhe që mund të krahasohej me të.

«Pasojat nëpër të cilat kisha kaluar vjetët e fundit dhe rrëfimet që më kishte bërë sulltani në shumë raste, — na thotë Ismail Qemali vetë, — më patën bindur që mund të fitoja prej sulltanit çdo gjë që ma donte zemra në udhën e karrierizmit e të përfitimeve, por absolutisht asgjë nuk mund të fitoja prej tij po të punoja për atdheun».

Dhe Ismail Qemali zgjodhi udhën e dytë, braktisi gjithë ofiqet më të larta që e joshnin, dhe zgjodhi rrugën e mundimeve në shërbim të popullit shqiptar. Sigurisht ikja e tij nga Turqia ka lidhje edhe

me gjithë ato mosmarrëveshje që ekzistonin midis atij edhe sundimtarëve turq për çështjet e përgjithshme të perandorisë otomane, por nuk ishte ky shkaku kryesor. Shkakun kryesor na e tregon vetë Ismail Qemali:

«Dyshimet se qëllimi i emërimit tim nuk ishte as të më jepte mua sadisfaksion as dëshmi e sigurtë për ta organizuar atë Vilajet, dhe të gjitha sa kisha vuajtur e pësuar kohët e fundit më bindën se udha më e mirë për mua ishte t'i jepja fund kësaj gjendjeje një herë e mirë e përgjithmonë dhe të largohesha në Evropë, ku pikë së pari mund të gëzoja një farë masë lirie personale, dhe së dyti, mund të ndiqja zhvillimin e ngjarjeve që të bëja diçka të dobishme për atdheun tim, Shqipërinë».

## DISA PËRFUNDIME

Si nëpunës i Turqisë, Ismail Qemali u lidh me ato rrethe shoqërore, të cilat nuk i çmonin më në atë kohë metodat e vjetra të sundimit. Transferimet e shumta e bënë Ismail Qemalin të njihte gjendjen e vërtetë të shoqërisë turke të atëhershme, të kombësive joturke dhe të bindej për nevojën e ndryshimeve të thella rrënjësore. Ai e kuptoi mirë se sistemit feudal turk i kishte kaluar koha. Ai jo vetëm që e kuptoi këtë gjë, por edhe vetë u bashkua me forca që përkrahnin transformimet borgjeze dhe u bë zëdhënës i tyre.

Ismail Qemali kishte një urrejtje të papërmbajtur kundër administratës dhe sistemit politik anadollak që ishte zhytur në korrupsion të pashërueshëm, që ishte i paaftë të vinte në jetë edhe reformat më gjysmake borgjeze. Ai në raportet e tij nuk lë rast pa u shprehur kundër këtij sistemi të korrupsionit; gjersa edhe në memorandumet që i drejtonte sulltan Hamitit nuk e fshihte këtë qëndrim të tillë dhe e quante të domosdoshëm ndryshimin rrënjësor të këtij sistemi.

Ismail Qemali e kuptoi gjithashtu se sistemi feudal turk kishte shkaktuar një prapambetje të madhe ekonomike në gjithë krahinat e perandorisë dhe



shihthe në këtë prapambetje një nga burimet kryesore të amullisë së asj që e shpinte drejt dekadencës e shkatërrimit. Por ajo që e revoltonte më tepër në këtë drejtim dhe që ishte pasoja direkte e sistemit ekonomik feudal qe gjendja e mjeruar dhe varfëria e tmerrshme e masave të popujve të perandorisë. Ismail Qemali u shpreh për krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin ekonomik, dhe aq sa mundi u përpoq të vërë në jetë masa që e ndihmonin këtë.

Ismail Qemali prapë kuptoi se në atë sistem të egër të shtypjes nacionale që mbretëronte në kuadrin e perandorisë turke, Turqia kishte hyrë në një rrugë pa krye, në një qorrrokak; dhe më shumë se një herë shprehu indinjatën e tij për shfaqjet më të shëmtuara të diskriminimit racial, nacional dhe fetar. Nuk mund të mos e simpatizosh Ismail Qemalin për protestat e tij kundër ndjekjeve të ashpra ndaj lëvizjeve çlirimtare të armenëve, të grekëve, të kretasve, të çerkezëve e të shqiptarëve. Ismail Qemali qysh në atë kohë tregoi se po të mos u jepej autonomia, të drejtat dhe liritë këtyre kombësive, bashkimi i përdhunshëm i popujve të perandorisë otomane do të shkatërrohej për turp; jo se i vinte keq Ismail Qemalit për shkatërrimin e këtij bashkimi të përdhunshëm, po se ai e kuptoi se shtetet e ndryshme kryesore evropiane, pasi kishin ndarë midis tyre gjithë botën, e shikonin perandorinë turke si një objekt të ri për pasurimin e tyre, si një plaçkë tregu që mund ta ndanin; dhe kjo, veçanërisht për kombësitë joturke, mund të kishte qenë fatale: në përpjekjet e tyre për të fituar lirinë nga Turqia, do të bëheshin koloni të shteteve të tjera evropiane, ashtu siç ngjau me Bosnjën dhe Hercegovinën. Ky rrezik bëhej edhe më i madh për popullin shqiptar, gjë që

caktohej edhe nga vetë pozita gjeografike e vendit, nga pikësynimet ekspansioniste të fqinjëve tanë. Kë-të gjë e kuptoi fort mirë Ismail Qemali në atë kohë.


Përpara kësaj gjendjeje, Ismail Qemali shihte vetëm një rrugëdalje: zbatimin e reformave të thella për një ndryshim rrënjësor në sistemin politik dhe ekonomik dhe në marrëdhënjet e kombësive joturke. Madje ai edhe në memorandumet që i drejtonte sulltanit, e theksonte se fjala nuk ishte për disa reforma të cinguara që i imponoheshin Turqisë në mënyrë imediate nga vështirësitë e kohës, por për reforma rrënjësore, të cilat duhej ta tërhiqnin Turqinë sa më parë në rrugën e zhvillimit përparimtar.

Po nuk mund të lëmë pa vënë në dukje se Ismail Qemali, duke u paraqitur si një partizan i reformave borgjeze për një kohë të gjatë, e quante të mundshme zbatimin e tyre nga lart. Në këtë qëndrim të tij prej borgjezi liberal nuk mund të mos kenë ndikuar një sërë rrethanash. Historia e tregoi se në gjysmën e dytë të shekullit XIX në Turqi nuk ishin pjekur në masën e duhur forcat shoqërore që mund t'i zbatonin këto reforma me metodat më radikale nga poshtë. Sidoqoftë, Ismail Qemali në atë kohë u lidh me forcat më përparimtare të kohës. Vetëm largimi i Ismail Qemalit prej Turqisë ishte një shenjë që tregonte se ai nuk besonte më në mundësinë e zhvillimit të këtyre transformimeve nga lart.

Të gjitha këto, pra, kanë lidhje me veprimtarinë e Ismail Qemalit si funksionar i lartë i Turqisë, dhe në këtë pikëpamje na paraqitet si një personalitet shtetëror përparimtar që hyri për herë e më thellë në opozitë të papajtueshme me regjimin ekzistues. Gjithashtu në jetën e Ismail Qemalit gjer në vitin 1900 ka dhe një çast tjetër shumë të rëndësi-

shëm me vlerë edhe më të madhe për ne: ky çast lidhet me veprimtarinë e tij patriotike në dobi të autonomisë së kombit shqiptar. Kur flitet për jetën e Ismail Qemalit, fillimet e veprimtarisë së tij patriotike kërkohen nganjëherë pas vitit 1900. Po të veprosh kështu, do të thotë të gjendesh përpara një metamorfoze të pashpjegueshme. Në periudhën para vitit 1900 Ismail Qemali nuk shquan shumë e aq sa prisnin rrethet e patriotëve se ai pati qenë larg, tepër larg Shqipërisë e popullit të vet. Por atë e patën mbajtur larg ata, të cilët i kishin frikën dhe e syrgjynosnin nëpër Anadoll.

Prandaj mund të themi, që kur Ismail Qemali ishte larg, ai ishte edhe afër Shqipërisë. Ndonëse të pakta janë faktet mbi veprimtarinë patriotike aty para vitit 1900, ato janë të mjaftueshme për të na treguar se kjo periudhë ishte përgatitore për atë punë të re të madhe që duhej të bënte e që bëri Ismail Qemali më vonë. I mbyllim këto përfundime duke pohuar se Ismail Qemali u largua nga Turqia jo që të kthehej përsëri në Turqi, po që t'i kthehej Shqipërisë e popullit të vet.



Ismail Qemali në vapor duke u nisur nga Triesti për  
në Turqi.

## MËRGIMI I PARË

Largimi i Ismail Qemalit nga Turqia ishte kuro-rëzimi i gjithë veprimtarisë së tij të mëparshme dhe fillimi i një periudhe të re kur puna e tij patriotike del në plan të parë.

Me sa qartësi profetike e kuptoi dhe e shprehu poeti i ri Duce Jorgo Baba këtë ndryshim pozitiv në jetën e Ismail Qemalit kur shkroi vjershën:

*Fryte, dritë e Shqipërisë,  
Jashtë nga qytet i errët,  
T'i vëç dërmën dhëlpërisë,  
E të gëzoç na të mjerët.*

*Ti që kur dole në jetë,  
Që kur bëri nëna djalë,  
Kokën e mbajte përpjetë,  
Edhe shpirtin zjarr e valë.*

Ditën e nisjes për në Tripoli, Ismail Qemali, në vend që të shkonte në jahtin turk *Fuart*, kërkoi mbrojtjen nga ambasada angleze dhe hipi në një vapor anglez. Më 1 maj 1900 i la shëndenë Stambollit. Në Pire e pritën si mysafir të lartë të qeverisë

greke. Që atë ditë shkëmbeu vizita me kryetarin e Këshillit të Ministrave Theotokun, dhe ditën e tretë u prit në audiencë prej mbretit Jorgo.

Autoritetet greke duhet të kenë pasur dy arësye që e pritën kaq mirë Ismail Qemalin: e para, më e mundshmeja, është se në personin e tij autoritetet greke shihnin njeriun që kishte hyrë në opozitë me qeverinë turke, e cila ishte edhe armike e tyre, dhe atë si një burrë shteti që kishte mbrojtur të drejtat e popullsisë greke të Kretës; e dyta, duhet të ketë qenë dëshira e tyre për ta bërë për vete këtë personalitet politik dhe për ta shtënë në kurthin e planeve ekspansioniste të tyre — plane që drejtoheshin kundër Shqipërisë. Në këtë mes, në qoftë se me të vërtetë ka ekzistuar ky shkak i dytë, autoriteteve greke u shkoi mundimi kot! Nga ana e tij Ismail Qemali, me vizitën që bëri në Athinë, provoi nëpërmjet sondazheve të tija politike, se sa i mundur ishte bashkëpunimi i forcave patriotike shqiptare me autoritetet greke kundër Turqisë.

Nga vizita e tij në Athinë, përshtypjet e mbresat kryesore Ismail Qemalit nuk ja lanë takimet që pati me diplomatët grekë, por ato që pati me një sërë grekësh me origjinë shqiptare dhe me barbaçët, midis të cilëve kishte shumë syresh që qenë të përballuar për vendlindjen e stërgjyshërve dhe i shprehën Ismail Qemalit dëshirën për ta parë të lirë vendin e tyre.

Ai vetë na tregon: «Isha krenar e kënaqesha kur vija re se si ndjenja e kombësisë shqiptare qe rrënjosur thellë në zemrën e shqiptarëve të Greqisë, me gjithë ndryshimet në konditat politike e sociale prej kaq shekuish. Ndjenja një gëzim të madh kur shëtisja mëngjezeve në qiellin e bukur të Atikës dhe

dëgjoja gjuhën time amtare të flitej nga shqiptarët rrugëve dhe në pazar; po ç'më dha kënaqësinë më të madhe, qenë fjalët e adjutantit të mbretit, i cili zbriste prej një familjeje nga më heroiket e Shqipërisë, tek po ecnim nga paradhoma drejt odës së pritjes në audiencën e dytë me mbretin: «Bej», më tha «mos u gënje nga këta kokëshkrepur; përpiqu për një Shqipëri të lirë që të mblidhemi atje gjithë bashkë».

Në Athinë Ismail Qemali u takua me shumë patriotë shqiptarë, ndër të cilët me mikun e tij të vjetër për çështjen shqiptare Jani Vreton, dhe me ata bisedoi gjerë e gjatë për hallet e vendit tonë dhe për përpjekjet që duheshin shtuar për zgjerimin e lëvizjes nacionalçlirimtare. Po në Athinë dhe po në atë kohë Ismail Qemali shkroi disa proklamata, të cilat ua drejtoi gjithë qendrave kryesore në Shqipëri, duke u shpjeguar bashkatdhetarëve të tij, së pari, shkaqet që e patën shtrënguar të braktiste postin e tij dhe shërbimin në perandorinë turke. Pastaj Ismail Qemali hartoi programin e tij politik që duhej të ndiqte për të shpëtuar Shqipërinë nga ndonjë fatkeqësi tjetër kombëtare në të ardhmen.

E treguam gjerësisht qëndrimin e Ismail Qemalit në Athinë se prej kësaj kohe ngjau një përçarje në opinionin publik rreth personalitetit të Ismail Qemalit, dhe disa patriotë shqiptarë nisën në shtypin e atëhershëm një polemikë të rreptë, duke e quajtur Ismail Qemalin «agjent» të Greqisë. Koha disi e zgjidhi këtë çështje, po edhe më fort do të vihet në dukje kur të mblidhen gjithë aktet dhe faktet rreth politikës së Ismail Qemalit në lidhje me qeverinë greke dhe të shkruhet biografia e plotë e tij.

Këtë qëndrim politik miqësor në marrëdhënjet

me grekët Ismail Qemali e mbajti gjer në fund. Që kur ishte ende në Turqi ai kishte bërë përpjekje jo pa sukses për t'i bindur udhëheqësit e elementit grek që jetonin në perandorinë otomane se ishte dhe në interes të tyre të bashkëpunonin me shqiptarët dhe me turqit përparimtarë me synim që të mbanin statu quo-n nën një Turqi, e cila duhej të zbatonte reformat. Por në lidhje me këtë vijë politike ai gjente rezistencë jo të vogël pranë qeverisë së Athinës dhe më tepër akoma pranë organizatave shoviniste greke që vepronin brenda në Greqi. Ismail Qemali ishte kategorikisht kundër çdo federate shqiptaro-greke. Ai u përpoq ta bindte qeverinë e Athinës për një bashkëpunim shqiptaro-grek në bazën e barazisë së plotë të të dyja palëve dhe arriti të lidhte me të një marrëveshje për një bashkëpunim shqiptaro-grek, sidomos kundër rrezikut të zgjerimit të shtetit bullgar, që çënonte interesat greke në Maqedoni dhe interesat shqiptare në Kosovë. Ismail Qemali mendonte se ky bashkëpunim do të vazhonte dhe pas zhdukjes së perandorisë turke. «Duke punuar që sot, — deklaronte ai, — për të qenë gati në eventualitetin e një ndryshimi ballkanik, unë nuk besoj aspak se mund të lindin çështje tokësore me rëndësi sa të dobësojnë «marrëveshjen» dhe të krijojnë mosmarrëveshje në të ardhmen. Shqiptari që njihet si i tillë për gjuhën e vet, për historinë e vet dhe ndërgjegjen e vet, do të qëndrojë atje ku efektivisht është; po kështu edhe greku».

Pasi arriti Ismail Qemali në Athinë, përnjëherësh e vizitoi miku i tij Iljaz Beu, të cilin e dërgoi sulltani ta bindte të arratisurin të kthehej në Stamboll, duke i dhënë gjithë garantitë për të ardhmen; po ashtu Qamil Pasha, ishte vezir i madh dhe në atë



kohë vali në Izmir, i dërgoi me anën e kryetarit të bashkisë Eshref Pashës, një letër shumë miqësore, ku ai personalisht bëhej garant për konsideratat e sulltanit në të ardhmen, dhe e këshillonte Ismail Qemalin të pranonte postin e valiut të Bejrutit.

Gjithë këto garantira të dhëna nga personalitete politike e nga miq personalë, Ismail Qemalit ju dukën krejt të padobishme. Pas Athinës u nis për një udhëtim të gjatë nëpër Evropë. Në udhëtimet e tij nëpër Evropë Ismail Qemali vajti kudo të takohej me miqtë e vjetër dhe të bënte miq të rinj; vajti të bënte sondazhe në rrethet politike të shteteve përrëndimore dhe të ngjallte interesimin e tyre për çështjen shqiptare. Bisedimet që zhvilloi me ata kishin për qëllim interesimin e tyre në fushatën që kishte nisur për mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar. Këtë karakter patën takimet e tij në Itali me ambasadorin anglez në Romë Currier, me sinjor Soninon dhe me kryetarin e konsultës, diplomatin plak Viskonte Venostën, i cili tregoi interesim të madh për Ismail Qemalin; dhe me diplomatë të tjerë. Një kënaqësi të veçantë i dha Ismail Qemalit takimi me Krispin<sup>1)</sup>, i cili, duke biseduar shqip me të, i foli me mburrje për origjinën e vet shqiptare.

Brenda muajit u nis prej Italisë për në Zvicër. Në Gjenevë e lajmëruan se sulltani, përveç sikarëve që ja kishte nisur prapa për ta vrarë, kishte dërguar agjentët e vet në Shqipëri që të bënin propagandë kundër Ismail Qemalit dhe të ndiznin urrejtjen e bashkatdhetarëve të tij. Esad Pashë Toptani, shefi i

---

1) Francesco Crispi, arbëresh (1818-1901), ish-kryeministër i Italisë.

xhandarmërisë së Janinës, vajti në Vlorë dhe i kërcënonte ata që nuk i jepnin me të shkruar se nuk e aprovinin punën e Ismail Qemalit.

Vizitat nëpër Evropë nuk ishin të pavlefshme për Ismail Qemalin. Aty-këtu ai gjeti ndonjë personalitet politik që e përkrahu çështjen shqiptare, si për shembull Wuickham Steed dhe Uilljam Fullerton, të cilët ja kemi hua faktin që e nguti Ismail Qemalin të na lënë «Kujtimet». Mirëpo ata që e përkrahën nuk ishin njerëz që vendosnin politikën e shteteve evropiane, ata vetëm simpatinë e tyre mund të shprehnin. Gjithë këto vizita i ndihmuan Ismail Qemalit të kuptonte mirë se shtetet perëndimore nuk mund t'i jepnin përkrahjen që kërkonte ai vetë, sepse interesat e tyre nuk përputheshin me ato të Shqipërisë. Ismail Qemali pikërisht në këtë kohë nisi të kuptonte thellë e mirë se çështja shqiptare nuk mund të zgjidhej nga vullneti i mirë i rretheve diplomatike të shteteve dhe se duhej të bëhej çështje e vetë shqiptarëve. Ai vetë u përpoq t'i njihte mirë kombinacionet diplomatike dhe të dilte nëpër labirintin e tyre faqebardhë. Prandaj ai filloi t'u drejtohej rretheve patriotike shqiptare dhe mendoi të organizonte botimin e një gazete, e cila të shpallte pikëpamjet politike të Ismail Qemalit dhe të bashkonte patriotët shqiptarë brenda dhe jashtë Shqipërisë në një lëvizje të vetme e të përgjithshme. Duke pasur gjithnjë këtë qëllim në kokë Ismail Qemali vajti dhe në Bruksel ku botohej revista «Albania».

*Albania* 1900 Nr. 8, Viti IV, shkruan nën titullin *Ismail bej Vlora*: «Ky shqiptar i ndritshëm vate në London duke shkuar nga Brukseli, dhe patëm prandërin të piqemi e të kuvendojmë me Z. T. gjerë e gjatë për punët e Shqipërisë. Shumë njerëz me

shkallë të lartë e kanë për së largu famën më të madhe se vlerën e vërtetë. Ismail Qemal Begu përkundra, sado që e ka të madhe famën, edhe më tepër e ka vlerën, dhe u gëzua me e na u ngroh zemra duke parë se Shqipëria mund të mburret që ka një djalë me mendime aq të shëndosha e me zemër aq mirë të lindur.

«Ismail Qemal bej Vlora — shumë herë mytesarif, dy herë vali i Bejrutit, i Shamit dhe i Tarabullusit, këshilltar shteti, e më në fund prapë sundimtar i përgjithshëm i Afrikës Turke — i shërbeu dyzet vjet Dvletit në punë të ndryshme, dhe kurdo e kudo me nderësi të madhe e me një të flaktë dëshirë lirie. E në këto të përvojtura dyzet vjetësh, ju mpreh edhe më tepër mendja; e kur flet për Shqipërinë mendimet e tija janë të kulluara e të thella.»

«Ismail Qemal bej Vlora thotë se ne shqiptarët nuk duam të ndahemi nga Turqia. Përkundër ja duam mbrojtjen Turqisë. Po mjaft punuam për botën. Këtë e tutje duam të punojmë kësi mënyrë që, po vuajti Turqia nga faji i osmanllinjve, të mos bjerë edhe Shqipëria; po ne shqiptarët jemi gati për të jetuar një jetë kombëtare. Ashtu qoftë.»

Po në këtë numër të Albanisë jepet lajmi se *Albania e Vogël*, gazetë politike që dilte në Bruksel bashkë me Albaninë, boton në numrin e fundit këtë artikull të Ismail Qemal Vlorës:

«Shqiptarët që rrojnë në Kosovë, në Shkodër, në Manastir, në Janinë, si edhe në vise të tjera të Turqisë Evropiane, duhet ta shikojnë veten si një trup dhe një popull të vetëm, pa dallim fisi dhe feje; duhet të jenë të gjithë si vëllezër: jeta, nderi, pasuria dhe besimi i secilit janë nën mbrojtjen dhe mbahen me ndihmën e të gjithëve. Ata që pengojnë

këtë marrëveshje bashkimi, janë fajtorë dhe shkelin parimet e drejtësisë. . . »

«Duhet që shqiptarët të jetojnë në paqe me fqinjët e tyre dhe të njohin të drejtat e tyre, po as fqinjët nuk duhet të ushqejnë qëllime të liga kundër popullit tonë. Shqiptarët kanë ndër mend t'u kërkojnë Fuqive Evropiane që të zbatohet ajo pjesë e Traktatit të Berlinit që ka lidhje me interesat e tyre, por me disa ndryshime që janë bërë të nevojshme nga koha e sotme dhe nga nevojat e vendit tonë. Populli shqiptar e di gjendjen e tij dhe thotë se është duke ecur në rrugën e qytetërimit; po, meqë është populli më i lashtë i Evropës, shpreson të meritojë dashamirësinë e botës së qytetëruar dhe kërkon të përfshihet në rrethin e vendeve të qytetëruara të Evropës, si për shkak të lashtësisë së tij, ashtu edhe për rëndësinë e pozitës së tij gjeografike. Klasat udhëheqëse të Gegërisë dhe të Toskërisë, si edhe shqiptarët e tjerë që ushtrojnë ndikim mbi popullin, do t'u drejtohen sulltanit dhe kabinetëve të Fuqive të Mëdha për të kërkuar për Shqipërinë një administratë të aftë të ruajë gjendjen e tanishme dhe të shtojë autoritetin e qeverisë. Shqiptarët, për ta provuar se qëllimet e tyre nuk janë në kundërshtim me unitetin e perandorisë, me integritetin e saj dhe me qetësinë e Evropës Lindore, për të treguar se ata synojnë vetëm të ruajnë kombësinë e tyre dhe t'i tregojnë botës se ekziston me të vërtetë një popull shqiptar, krejt i ndryshëm nga popujt fqinjë, dhe për të siguruar jetën politike të vendit në të tanishmen dhe në të ardhmen, do të kërkojnë ndihmën e gazetave të Evropës dhe do të themelojnë gazetatat e tyre në gjuhët shqipe dhe turke».

Pas kësaj thirrjeje të botuar shqip në revistën

«Albania» të Brukselit, Ismail Qemali i dha gazetës «Tribuna»<sup>1)</sup> një intervistë, e cila u botua italisht bashkë me thirrjen shqiptarëve. Në këtë intervistë Ismail Qemali në fakt jep programin e tij.

«Qëllimi që duhet të kenë gazetat kombëtare është të hapin sytë e shqiptarëve të të gjitha krahinave dhe feve, t'i zgjojnë dhe t'u tregojnë atyre rreziqet që i rrethojnë dhe që po bëhen më të rënda dhe më të mëdha dita-ditës. Ne nuk duam as turbullira, as kryengritje, dhe aq më pak duam që të turbullohet paqja e popujve që jetojnë në gadishullin Ilirik. Ne dëshirojmë vetëm dhe me gjithë zemër bashkimin dhe unitetin e racës sonë shqiptare, përparimin e saj intelektual e ekonomik, në mënyrë që të bëhemi aq të fortë, sa t'u kundërshtojmë të gjithë atyre që duan të na shkelin ne dhe popujt e tjerë, për të cilët jemi të interesuar që të rrojnë, sepse ekzistenca e tyre përkrah edhe ekzistencën tonë. Për të përparuar në rrugën e qytetërimit, ne kemi nevojë të mësojmë; prandaj duhet të hapim shkolla kombëtare në të gjithë Shqipërinë, në mënyrë që gjuha shqiptare të përhapet dhe të lexohet anekënd vendit. Nevoja e shkollave është reforma e parë që duhet të kërkojmë. Është e pamundur që një popull të përmirësojë gjendjen e tij pa shkolla dhe pa arësim».

«Populli shqiptar, populli më i lashtë i Gadishullit Ilirik nuk mund të qëndrojë indiferent dhe duar-kryq dhe të shikojë përparimin dhe përmirësimin e popujve të tjerë; nuk mund të mos përpiqet dhe të orvatet që të ecë me nder e vendosmëri në rrugën e diturisë dhe të qytetërimit. Njeriu duhet të jetë fare i verbër që të mos e shohë nevojën e shkollës

---

1) «Tribuna», gazetë e botuar prej arbëreshëve.

kombëtare; duhet të jetë tradhëtar që të dëshirojë lënjen pas dore të arësimit në gjuhën shqipe. Ata që duan të rrojnë në errësirën e paditurisë, pa gjuhën dhe kombësinë e tyre, dëshirojnë t'i pregatisin Shqipërisë një vdekje të turpshme. Ne nuk dyshojmë aspak se shqiptarët, të cilët përmes shumë rreziqeve dhe me shumë sakrifica kanë ditur të ruajnë heroikisht emrin e tyre gjatë shumë shekujve, do të rrokin pa vonesë armët e arësimit kombëtar, armë të forta që mund të shpëtojnë jetën e tyre dhe mund t'i bëjnë ballë çdo përpjekjeje çkombëtarizimi. Është e kotë të pyesim në do të përpiket qeveria turke të ngrejë pengesa dhe të shuajë këtë dëshirë. Për fat të keq të turqve dhe të popujve që duan të mbeten miq të tyre, qeveria turke gjithmonë, çdo herë dhe kudo nuk e di atë që bën vetë. Për të ruajtur vetëveten, Turqia nuk ka ndihmë tjetër në Evropë përveç asaj të shqiptarëve; sa më të fortë të bëhen shqiptarët, aq më tepër sigurohet ekzistenca e Turqisë. Dhe si mund të forcohen shqiptarët, po nuk u bënë një popull i pavarur me gjuhë dhe ligje të tyre? Po të shqyrtohet puna më thellë, duket sheshit se vetë Turqia duhej t'i ndihmonte shqiptarët për të dalë të pavarur. Po meqë Turqia nuk i di detyrat e saja, ne shqiptarët që i dimë tonat do të punojmë dhe do të përparojmë pa ndihmën e saj».

«Të flasim tani për konditat e vendit; t'i hedhim një sy hartës gjeografike, të shikojmë mirë krahinat, ku jeton raca jonë e fortë dhe t'i krahasojmë ato me viset e popujve fqinjë».

«Ndryshimi është shumë i madh. Në Shqipëri shohim fusha madhështore, por të papunuara; lumënj që mund të vaditnin tokën duke e bërë edhe më pjellore dhe që mund të përdoreshin për të trans-

portuar kudo prodhimet tona, po që në të vërtetë janë një rrezik i vazhdueshëm për drithërat dhe vreshtat dhe një pengesë për tregëti; pyje të mrekullueshme që mund të ishin një burim pasurie, po që mbeten të paprekura dhe të egra si në kohrat e lashta; miniera të çmuara, për të cilat nuk interesohet njeri. Nuk kemi rrugë, nuk kemi ura, nuk kemi siguri. Tani t'u hedhim një sy viseve të fqinjëve tanë. Sa ndryshim i madh! Sa e varfër dhe e egër duket toka jonë! Dhe kush e ka fajin? Fajin e ka qeveria turke, e cila nuk do aspak përparimin e popujve dhe lejon që të shuhen dhe të katandisen si mos më keq vende dhe krahina që në kohrat e lashta ishin aq të pasura, sa tani nuk të besohet. Një qeveri që ndalon çdo përparim, që kundërshton dhe pengon çdo përpjekje arësimi dhe industrializimi, nuk bën tjetër veçse dekurajon dhe armiqëson popujt e nënshtruar, që më së fundi humbasin besimin dhe durimin dhe nuk kanë forcë të hyjnë në rrugën e qytetërimit. Prandaj shqiptarët dergjen në një apati të mjerueshme dhe në një gjumë të thellë. Po ka ardhur koha që tani të gjithë të shkunden e të hapin sytë, t'i kërkojnë qeverisë për atë që bën me paratë që nxjerr nga Shqipëria; ta detyrojnë që këto para të shpenzohen në Shqipëri dhe për të mirën e saj, siç është e drejta, në mënyrë që vendi ynë të lulëzojë dhe të bëhet prapë i pasur. As mjetet, as inteligjenca nuk na mungojnë; vetëm vullneti dhe një dashuri e madh mjaftojnë për ta bërë Shqipërinë ashtu siç meriton të jetë, si për pozitën e saj gjeografike, ashtu edhe për famën që gëzon në historinë e lashtë. Të gjithë sa jemi shqiptarë të mëdhenj e të vegjël, të pasur e të varfër, pleq e të rinj duhet të bashkohemi dhe të çojmë vendin përpara në rrugën

e qytetërimit dhe të përparimit, duke i treguar Evropës se shqiptari ka mbetur gjithmonë evropian në gjak dhe se nuk dëshiron gjë tjetër veçse të forcojë kombësin e tij dhe të qytetërohet. Për t'ja dalë ndanë kësaj detyre të përtëritjes kombëtarev të shqiptarëve, është e domosdoshme që secili prej nesh të heqë dorë nga inatet, armiqësitë dhe dëshirat e hakmarrjes që mund të ushqejë në zemrën e tij; të mos ketë qëllim tjetër, përveç madhështisë së atdheut, bashkimit të të gjitha forcave tona, unitetit të të gjithë elementit shqiptar, për ta bërë Shqipërinë një vend më vete, të ndryshëm nga vendet e tjera të Ballkanit. Koha nuk pret, bota ecën përpara, dhe mjerë ne po të mos dimë të përfitojmë nga ky rast i mirë; mjerë ne, po t'i lëmë popujt e tjerë të na kalojnë në rrugën e qytetërimit».

Pa bërë ndonjë krahasim të gjatë — se nuk është vendi në një biografi të shkurtër si kjo — midis veprimtarisë së Sami Frashërit dhe Ismail Qemalit për çlirimin e Shqipërisë, mund të themi pa gabuar, se atë që bëri Sami Frashëri në Shqipëri me anën e librit «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është, e ç'duhet të jetë», e bëri Ismail Qemali me praninë, me programet e thirrjet e tija në kolonitë shqiptare dhe nëpër qarqet diplomatike përjashta.

Shumë kuptimplotë është interesimi që tregoi Ismail Qemali, pasi iku nga Stambolli, për të vizituar kolonitë arbëreshe në Kalabri dhe në Siqili. Arbëreshët, gjatë qëndrimit të tij në Romë e Napoli, e vizitonin përgjithnjë veç e veç e me delegacione dhe e ftuan që t'i vizitonte nëpër fshatrat e tyre. Duke u ndodhur në mes të këtyre vëllezërve shqiptarë ai kënaqej nga dashuria që dëftenin ata për tokën e humbur dhe për çlirimin e saj. Një përshkrim të



bukur të vizitës së Ismail Qemalit në këto koloni më 1907 e jep Petro Kadikamoja në librin e Skalionit.

Me gjithë përpjekjet e tij të singerta, Ismail Qemali hasi vështirësi serioze në punën e tij për bashkimin e patriotëve. Një nga shkaqet që e pengoi është përpjekja e disa shqiptarëve, të cilët, duke u aktivizuar në lëvizjen patriotike, nuk harronin të mbronin edhe interesat e atyre shteteve të huaja, me të cilat ishin lidhur në një rën ose tjetrën mënyrë. Si shembull mund të përmendim këtu qëndrimin e Faik Konicës; në fillim duket sikur redaktori i Albanisë u tregua etuziazt ndaj Ismail Qemalit; por dihen përpjekjet e tija të mëvonshme e të vazhdueshme për ta diskredituar Ismail Qemalin. Në fund të fundit kjo gjë e kishte burimin në pakënaqësinë e Faik Konicës dhe të zotërve të tij, të cilët e urrenin Ismail Qemalin për rezervat e shumta që shfaqte ai ndaj politikës ekspansioniste të Austro-Hungarisë në Ballkan.

## «SHPËTIMI I SHQIPËRISË»

Marrëdhënjet e Ismail Qemalit me Faik Konicën nuk zgjatën shumë. Pasi nuk mundi ta bëjë «Albaninë» organ të të gjithë shqiptarëve, Ismail Qemali nisi botimin e fletores *Le Salut de l'Albanie* (Shpëtimi i Shqipërisë), nën kushte botimi shumë të vështira, gjë që nuk e lejoi të vazhdonte gjatë.

Ja se si e ka formuluar qëllimin e organit të tij Ismail Qemali: «Veç kauzës në dobi të popujve orientale, ne duhet të mbrojmë interesat e popullit e të vendit tonë».

Në Bruksel Ismail Qemalin e vizitoi ambasadori i Turqisë në Londër, Munir Pasha, i cili i tha se kishte marrë nga sulltani këtë porosi: Mbasi madhëria e tij qe bindur se Ismail Qemali nuk do të pranonte më ndonjë post brenda perandorisë, në vend që të endej si një i arratisur, i jepej ofiqi i një ambasadori për gjithë vendet, me mision që të studjonte institucionet e ndryshme të Evropës dhe t'i dërgonte raporte mbi ta që t'i shërbenin sulltanit si bazë për reforma në Turqi.

Ç'na tregon ky interesim i jashtëzakonshëm i sulltanit për Ismail Qemalin? Na tregon se edhe larg Turqisë ku ndodhej Ismail Qemali, sulltani ja ndjente forcën shqiptarit patriot dhe trembej nga të papritu-

rat që mund t'i shkaktonte ai. Prandaj, pasi nuk mundi ta vrasë, përsëri përdori metodat e korupsionit aq të përbuzura prej Ismail Qemalit.

«Natyrisht unë e hodha poshtë këtë ofertë të çuditshme, duke ju përgjegjur se madhëria e tij e dinte fare mirë përse kisha hequr dorë nga çdo shërbim në perandorinë otomane, — thotë Ismail Qemali, — dhe për të njëjtat shkaqe nuk mund të pranoja ofiqin e parashtruar e të vazhdoja të rroja me rrogë turke si shpërblim për shërbime thjeshtësisht imagjinare».

Në Egjipt kishte pasur gjithmonë një koloni mjaft të madhe shqiptarësh, muslimanë e të krishterë, dhe komiteti i kësaj kolonie njoftoi Ismail Qemalin për kënaqësinë që do të ndjenin ta prisnin mysafir në Egjipt. Pasi edhe Ismail Qemali kishte pasur dëshirë ta vizitonte Misirin, e pranoi ftesën e bashkatdhetarëve të atjeshëm. Në Kajro e priti në audiencë Kedivi, regjenti i vendit, dhe shkëmbeu vizita me Lordin Groneg, i cili u zotua se do të kishte konsideratë të veçantë për Komitetin Shqiptar të atjeshëm.

Kur po kënaqej me pritjen e bashkatdhetarëve dhe me rrethet politike në Kajro, filluan përsëri intrigat rreth Shqipërisë. Një nga më të çuditshmet qe ajo e vëllajt të Kedivit, e Mehmet Ali Pashës. Megjithëse Ismail Qemalin nuk e njihte personalisht, e lajmëroi sulltanin me telegram se Ismail Qemali i paskësh ofruar fronin e Shqipërisë, të cilin ai, Mehmet Ali Pasha, tha se e refuzoi për shkak se kjo gjë ishte kundër ndjenjave të besnikërisë së tij ndaj Kalifit. Ky denoncim i solli pashajt gradën e titullin e vezirit. Por u duk se kjo intrigë duhej t'ja kishte vrarë ndërgjegjen Mehmet Ali Pashës, se gjatë vizitës së dytë të Ismail Qemalit në Egjipt, pashaj e

vizitoi dhe i kërkoi ndjesë duke shpjeguar se atë akt e kishte bërë nga një zell i tepruar. Duke u kthyer nga Egjipti në Romë, ambasadori turk e vizitoi dhe i tregoi një telegram prej sulltanit, me të cilin e porosiste përfaqësuesin e tij ta qërtonte Ismail Qemalin për faktin se, ndërsa i arratisuri i qe zotuar, sidomos me anën e Iljaz beut, se nuk do të merrej me politikë, megjithkëtë pati vizituar Egjiptin, pati bërë të ditur se përpiqej të krijonte një principatë shqiptare, dhe i pati ofruar fronin vëllajt të Kedivit. Dhe shtoi se po të mos i mohonte këto gjëra, do të dënohej prej gjyqit.

Ismail Qemali ju përgjegj se sulltani gabohej kur thoshte se diplomati shqiptar i qe zotuar të mos merrej më me politikë. I kishte premtuar vetëm se nuk do ta godiste personalisht madhërinë e tij, premtim të cilin edhe e kishte mbajtur. «Sa për Shqipërinë, unë nuk mund të falja fronin e një shteti që nuk ekzistonte, dhe, edhe sikur të mundja ta bëja këtë gjë, s'kisha shkak të preferoja një princ egjiptian, po përkundër».

Këtë intrigë të ulët qeveritarët turq e përdorën për një sulm të ri kundër Ismail Qemalit. Sulltani urdhëroi që Ismail Qemali të gjykohej në Stamboll për tradhëti të lartë; dhe gjyqi e dënoi me vdekje në mungesë, me humbjen e të drejtave civile, të rangut, të titujve, të dekoratave e të pasurisë personale.

Ja vlerësimi që i bënë armiqtë e kombit shqiptar Ismail Qemalit për punën e tij nëpër Evropë!

## KONGRESI I XHONTURQVE

Prej kohësh, në Turqi, siç u vu në dukje në kapitujt e parë, pati filluar lëvizja për ndryshimin e regjimit tiranik dhe për futjen e Turqisë në rrugën e zhvillimit përparimtar, të evropianizimit të Turqisë. Dihet se në kohën e vet Ismail Qemali që përkrahës i zjarrtë i këtij programi politik, të formuluar prej njerëzve si Reshit Pasha e Mitat Pasha, autorit të konstitucionit. Që nga ajo kohë, kjo lëvizje ishte rritur e zgjeruar: ajo përfaqësohej kryesisht nga xhonturqit; mirëpo për çudi, Ismail Qemali, që kishte qenë kaq partizan i vendosur i këtyre reformave, na paraqitet më vonë si një kundërshtar i xhonturqve. Pse ndodhi kjo përçarje vallë?

Që nga koha e Mitat Pashës e këtej, kishin ndryshuar rrethanat dhe programi politik i xhonturqve; panislamizmi dhe mohimi i të drejtave të pakicave të perandorisë kishte marrë formë të shëmtuar. Me shumë ide të xhonturqve Ismail Qemali pajtohej, por kurrësi nuk mund të pajtohej me shovinizmin e tyre, se ky shovinizëm kishte të bënte edhe me shtypjen e shqiptarëve, dhe me centralizimin e pushtetit turk.

Turqit që qenë larguar nga Turqia për arësye politike, prej të cilëve një pjesë e madhe u njohën me emrin xhonturq, turq të rinj, bënë plane të mbainin një kongres për të biseduar mbi gjëndjen e Turqisë. E ftuan edhe Ismail Qemalin. Ismail Qemali pranoi të merrte pjesë, por me disa kushte. Ai kërkoi, që, së pari, të përfaqësoheshin gjithë elementët etnikë në Turqi, në mënyrë që, në atë kongres, të formuloheshin dëshirat e gjithë popujve të perandoris. Sipas mendimit të Ismail Qemalit, kishte rëndësi që ata që qenë kundër Sulltan Hamitit të vepronin për të krijuar një qeveri kombëtare që do të ishte e paanshme dhe e dobishme për gjithë popujt e perandorisë.

Kjo opozitë e Ismail Qemalit u shfaq qartë në qëndrimin që ai mbajti në Kongresin e organizuar prej xhonturqve në Paris, më 1907.

Konditat e Ismail Qemalit u pranuan dhe ai vajti në kongres si përfaqësues i popullit shqiptar.

Çështja e parë që u diskutua atje qe të përcaktohej burimi i gjithë plagëve dhe të këqiave që kishte qeveria e Abdyl Hamitit. Shpejt kongresi u gjend ballë për ballë dy mendimeve krejt të kundërta nga njëri-tjetri. Njëri erdhi prej xhonturqve, e tjetri prej armenëve. Grupi i xhonturqve, i udhëhequr prej Ahmet Rizajt, ngulte këmbë për organizimin e një pushteti qëndror dhe centralizues në Stamboll në interes të elementit thjeshtësisht turk. Armenët, në anën e tyre, dëshironin që kombësive joturke, t'u jepej një autonomi sa më e gjerë prej administratës qendrore.

Pas bisedimeve të gjata dhe të bujshme, shumica e kongresit u muar vesh t'u bënte një apel Fuqive të Mëdha për një regjim në harmoni me parimet e

konstitucionit, që do të përfaqësonte gjithë elementët etnikë të Turqisë, duke garantuar drejtësi dhe liri, dhe ruajtjen e të drejtave të tyre kombëtare.

Ismail Qemali mbrojti pikpamjen, sipas së cilës kombësive joturke duhej t'u garantoheshin liria dhe të drejtat e tyre. Pakica, e përbërë nga ata që më vonë udhëhoqën lëvizjen revolucionare në Turqi, e kundërshtuan rezolucionin dhe i shtuan procesverbalit një kundërrrezolutë. Kjo kundërrrezolutë u bë baza e programit që zbatoi Komiteti për Bashkim dhe Përparim.

Në kongres, disa mendonin për masa violente, për kryengritje të përgjithshme, delegatë të tjerë qenë në dobi të masave të buta që nuk do të ipnin rezultate të shpejta. Qëndrimi i Ismail Qemalit në çështjen e rrugëve dhe metodave që duheshin ndjekur për arritjen e qëllimit me fjalët e tij ishte ky: «Unë vetë isha në favorin e një veprimi që do të kishte efektin e një alarmi, i cili do të tërhiqte vërejtjen e Evropës, dhe do ta shtrëngonte sulltanin të kërkonte të merrej vesh pa e zhytur vendin në gjakderdhje.» Dhe Ismail Qemali nuk mbeti vetëm me fjalë. Ai u muar vesh me marshallin e ushtrisë turke në Tripoli, Rexhep Pashën nga Mati, për të zbarkuar në ndonjë vend strategjik të Turqisë që do të shërbente si fillimi i përmbysjes së regjimit të vjetër turk. Mirëpo ngjarjet ndoqën njëra-tjetrën me atë shpejtësi sa që prej këtij plani nuk u realizua asgjë.

Që nga mbajtja e kongresit e gjer më 1908 Ismail Qemali e kaloi më të shumtën e kohës në Bruksel, ndonëse bëri disa udhëtime në Greqi, në Itali dhe në Angli.

E kësaj kohe është letra e hapur e Ismail Qe-

malit, drejtuar Sir Eduard Grey-t dhe M. Pichon-it, e cila mbaron me paragrafin:

«Pa një Shqipëri të organizuar mirë, të bashkuar e të fortë as integriteti i perandorisë otomane, nga njëra anë, nuk mund të ruhet, as ekuilibri i popujve ballkanikë nga ana tjetër, nuk do të vendoset mbi një bazë të shëndoshë. Vetë nevoja e kërkon që t'i njihet popullit shqiptar ekzistenca e tij nacionale dhe t'i jepen mjetet për ngritjen e zhvillimin e tij, që ashtu, në harmoni të plotë me bashkëbanorët e racave të tjera, të mundë edhe ky popull të ecë në rrugën e përparimit».

Ndodhej në Paris kur Muexhidin Beu, i ngarkuari me punë i Turqisë, e zgjoi në orën një të natës, duke u gdhirë 22 korriku 1908 që t'i tregonte një telegram prej sulltanit me këtë brendi: «Po të më kishte lejuar koha do t'i dërgoja Ismail Qemal beut njeriun tim të besuar, Iljaz Benë, të bisedonte me të se ç'duhet bërë në këtë ndodhje kritike. Shko tek Ismail Qemal beu pa vonesë dhe lutju të të japë opinionin e tij me të shkruar, të cilin do të ma dërgosh telegrafisht».

Prapa këtij telegrami fshihej Ferizaj: Duke parë se bashkimi kombëtar i tyre që në rrezik, dhjetëmijë shqiptarë qenë mbledhur në Ferizaj më 15 korrik 1908 dhe i dërguan sulltanit atë telegramin e famshëm që la në mendjen e tij një mbresë më të madhe se sa kërcënimet e të gjithë turqve të rinj.

Dhe cila që përgjegjja që i dha Ismail Qemali sulltanit? E vetmja këshillë që Ismail Qemali mund t'i jepte ishte të shpallte pa vonesë konstitucionin. Tjetër rrugëdalje nuk kishte.

Dy ditë më vonë u shpall konstitucioni.

Munir Pasha, ambasador turk në Paris, gjendej



me mision në Konstancë kur mori vesh revolucionin në Stamboll. Erdhi menjëherë në Paris dhe lajmëroi Ismail Qemalin se veziri i madh Qamil Pasha kërkonte që Ismail Qemali të kthehej në Turqi. Ismail Qemali ju përgjegj se nuk do të kthehej gjersa të mos anulohet vendimi kundër tij dhe t'i ktheheshin gjithë të drejtat civile. Përnjëherësh Ismail Qemali mori vesh me anën e ambasadorit vërtetimin se dënimi kundër tij qe anuluar dhe i qenë kthyer gjithë të drejtat. Po në këtë kohë gazeta «Standard» botoi një telegram nga Italia, sipas të cilit nja dymijë shqiptarë kishin ardhur në Bari që të përcillnin në Vlorë bashkatdhetarin e madh të tyre. Me një tjetër telegram parësia e vendit e ftonte Ismail Qemalin në Vlorë që të bëhej deputet i tyre në parlamentin e Turqisë.

## PËRSËRI NË TURQI

Ismail Qemali kur u kthye nga Evropa nuk mori udhën drejt për në Stamboll, por u ndal në Shqipëri.

Ismail Qemalit, kandidatit-deputet, në skelën e Vlorës ju bë një pritje madhështore. Populli i thjesh-të që kishte ardhur nga fshatrat përreth për t'i thënë «mirë se arde!» Ismail Qemalit, tregoi atë ditë se sa fort e mirë ja kishte kuptuar vlerën këtij biri të shquar të Vlorës, i cili pas atij «gurbeti» të gjatë kur zbriti në tokën amtare nuk pati ç't'i sillte Shqipërisë tjetër peshqesh përveç zemrës së tij të pastër shqip-tare.

Populli i nxori kuajt prej karrocës dhe duke tërhequr vetë arabanë e përcolli Ismail Qemalin drejt e në beledje (bashki).

Në kafenenë e skelës po rrinin të grumbulluar rreth Syrja Beut bejlerët e tjerë dhe «parësia» e vendit.

«Sa poshtë ka rënë fshati!» psherëtiti Syrja Beu, kushuriri i dytë i Ismail Qemalit. «E ç'të ka ky njeri që e presin me kaq salltanet? A mos të ka çifligjet e pallate? Le që s'ka sjellë gjë, po është mbytur edhe me borxhe nëpër hotelet e Evropës ku ka rendur si vagabond! Pa duan të na e zgjedhin edhe deputet!».

Syrja Beu shpresonte të fitonte vetë kandidaturën për deputet.

Fushata elektorale u zhvillua me gjallëri të madhe. Klubet shqiptare brenda e jashtë vendit zhvilluan një veprimtari të gjerë në dobi të kandidatëve shqiptarë, sidomos të Ismail Qemalit. Po turqit e rinj e luftuan atë si armik të tyre dhe bënë çmos që të mos fitonte në zgjedhjet. Ata madje u përpoqën të falsifikonin votat, duke dërguar repartet ushtarake nga njëri vend në tjetrin që të votonin shumë herë për kandidatët e turqve të rinj. Po çështja nuk qe a do të zgjidhej Ismail Qemali, po a do të zgjidhejshin të dy kushurinjtë Vrionas: Omer Pasha dhe Aziz Pasha. Ismail Qemali u zgjodh me shumicë dërrmuese votash megjithëqë ishte larguar prej kaq shumë vjetve nga Shqipëria dhe me gjithë propagandën e tërbuar që bënë agjentët xhonturq që të mos fitonte. Kur u zgjodh, xhonturqit i dërguan një doktor ushtrie, i cili e pyeti nga ana e Komitetit xhonturk që ç'ishte programi politik i tij, dhe Ismail Qemali ju përgjeggj: «Pikëpamjet e mia politike janë me të vërtetë mjaft të qarta nga vetë veprat e gjithë jetës sime, dhe se do të ishte fare e përshtatshme të pysja unë ata të Komitetit se ç'ishin pikëpamjet e atyre që po më hetonin mua».

Kur arriti në Stamboll në nëntor të vitit 1908, Ismail Qemali vuri re se turqit e rinj kishin fituar fuqi shumë të madhe. Këta u përpoqën që ardhja e Ismail Qemalit të mos merrte ndonjë karakter zyrtar, po megjithkëtë pritja që i bënë kolonia shqiptare dhe miqtë e tij personalë ishte nga më të shkëlqyerat. I dualën përpara me muzikë dhe e përcuellën në klubin shqiptar, ku u mbajtën plot fjalime patriotike. Ai vetëm mbas një jave mundi të takohej e të

çmallej me familjen e tij, aq të shumta dhe të pandërprera qenë vizitat që ju bënë Ismail Qemalit në hotelin Pera.

Të nesërmen e mbërritjes së Ismail Qemalit, veziri i madh, Qamil Pasha, e thirri në kryeministri dhe i shfaqti dëshirën ta kishte në kabinetin e tij si titullar të punëve të jashtme. Në parim Ismail Qemali e pranoi ofertën, por i tha se dëshironte, në radhë të parë, ta shihte pozitën e vezirit të forcuar prej votës së parlamentit pas deklaratës që do të bënte kryetari i kabinetit mbi vijën e politikës së tij. Njëkohësisht Ismail Qemali nuk e pranoi as kandidaturën për kryetar të parlamentit, në të cilën post u zgjodh Ahmet Rizaj, kryetar i xhonturqve në Kongresin e Parisit.

Zgjedhjet morën fund në dhjetor. Në parlamentin turk u zgjodhën 25 deputetë shqiptarë. Shumica e tyre ishin përfaqësues të çifligarëve të mëdhenj shqiptarë, ose funksionarë të lartë të administratës turke që nuk bënë asgjë për të mbrojtur interesat e vendit të tyre. Ata kishin mohuar kombësinë e vet dhe luftonin për të ruajtur interesat e ngushta të klasës. Ata të paktë deputetë shqiptarë që çuan zërin e popullit të tyre dhe vepruan në parlament si grup kombëtar, qenë Nexhip Draga, Hasan Prishtina, Shahin Kolonja e të tjerë, ndër të cilët më i shquari ishte Ismail Qemali. Ata u bashkuan me opozitën «liberale» që në dhjetor të vitit 1908 u formua si parti me emrin «Ahrar», në krye të së cilës u vu deputeti shqiptar Ismail Qemali. Në këtë parti bënë pjesë edhe kundërshtarët politikë turq të Komitetit «Bashkim e Përparim» që përfaqësonin interesat e rretheve reaksionare feudale-kompradore të Turqisë. Po në programin e saj partia «Ahrar» kërkonte de-

centralizimin e administratës dhe autonominë e provincave nacionale, prandaj deputetët e kombësive të shtypura të Turqisë e përkrahnin atë.

Kur u paraqitën një herë në parlament disa interpelanca dhe Qamil Pasha u thirr të vinte pa vonesë të përgjigjej, Enver Beu e të tjerë oficerë që loznin rol kryesor në komitetin e xhonturqve, të armatosur me revolvera e të tjera armë dhe të pasuar nga partizanët e tyre, mbushën korridoret e ballkonet e parlamentit dhe i shtrënguan deputetët të votonin kundër Qamil Pashës. Në të njëjtën kohë të tjerë shefa të komitetit në parlament përdorën gjithfarë kërcënimesh kundër kolegëve të tyre. Pas një gjurulldie të madhe xhonturqit, që kishin premtuar të mbështeteshin në vullnetin e lirë të parlamentit, e shkelën zotimin, dhe me forcë e detyruan parlamentin të votonte për të. Kurse Ismail Qemali kërkonte që parlamenti të shprehte lirisht vullnetin e tij, prandaj edhe i kundërshtoi. Të gjithë votuan kundër Qamil Pashës; me përjashtim të Ismail Qemalit, i cili protestoi kundër kësaj procedure të paligjshme, dhe përgatiti një urdhër dite, të cilin vetëm shtatë nga kolegët e tij patën guxim ta nënshkruanin. Në këtë mes vetë sulltani u tremb dhe e sanksionoi revokimin e Qamil Pashës. Në mënyrë fare antikush-tetuese u emërua kryeministër Hysen Hilmi Pasha. Edhe në aprovimin e këtij nga ana e parlamentit, Ismail Qemali ishte pothuajse i vetmi që votoi kundër.

Për gjithë çështjet që u trajtuan në mënyrë të paligjshme në parlament, Ismail Qemali mbajti qëndrim të hapur opozitar ndaj xhonturqve; pozita e tij qe përparimtare dhe humane. Po përmendim këtu debatin që u zhvillua për ligjin mbi komitat maqe-

donas; në këtë ligj xhonturqit parashikonin dënime të rënda për komitat e kapur. «Unë i kundërshtova të dyja masat, sepse qenë çnjerëzore dhe kundër një politike të drejtë. Përsa i përkiste të rrahurit, më dukej jashtëzakonisht ligj prapanik dhe poshtërues në një vend që kishte hyrë në radhën e Fuqive Evropiane dhe kërkonte të ndryshonte zakonet e tija sipas atyre të vendeve të Evropës. Ligjet drastike mbi bandat qenë edhe më barbare, që kur se përligjnin që, në rast se një pjesëtar familjeje qe bashkuar me bandat, gjithë familja duhej të syrgjynosej dhe pasuria të konfiskohej; në këtë mënyrë një fshat i tërë mund të ndëshkohej për veprën e një pjesëtari të komunitetit. Qëllimi kryesor i Komitetit të xhonturqve kur paraqiste të këtuillë ligjë qe vetëm që të rrëmbente gjithë fuqinë në duart e tij, që kështu të vepronte me ashpërsi kundër popujve të ndryshëm, po sidomos kundër shqiptarëve».

Duke forcuar pushtetin e tyre, xhonturqit filluan me forcë të madhe një sërë veprash të shëmtuara e arbitrare, të cilat u kundërshtuan me rreptësi prej Ismail Qemalit. Ky qëndrim opozitar i tij kundër xhonturqve për shumë çështje u shfrytëzua nga ata me qëllime të caktuara për të diskredituar këtë kundërshtar të politikës së tyre, dhe në atë kohë një nga mënyrat më të forta për t'ja arritur këtij qëllimi ishte ta akuzonin Ismail Qemalin si partizan të regjimit të vjetër. Kjo taktikë u përdor prej xhonturqve edhe ndaj gjithë atyre personave që kundërshtonin çdo akt të tyre arbitrar dhe shovinist. Mirëpo Ismail Qemali që qe hedhur në luftë aktive kundër Sulltan Hamitit përpara se të kujtoheshin shumë nga turqit e rinj, nuk kishte ndonjë arësye që të dëshironte të kthehej përsëri e vjetra. Kre-

doja e tij, të cilën Ismail Qemali ua kishte njoftuar edhe kryengritësve të Ferizajt, qe: «*As me turqit e vjetër as me turqit e rinj, por për Shqipërinë*». Prandaj pra, pavarësisht nga taktika që përdornin xhonturqit për ta diskredituar Ismail Qemalin, qëndrimi i këtij burrë shteti pati rëndësi për të shuar gjithë atë iluzion dhe shpresë që ushqente shumëkush se turqit e rinj mund të siguronin lirinë për popujt e perandorisë. Le të jetë ky sqarim i vlefshëm për të kuptuar ngjarjet që e detyruan Ismail Qemalin, pas atyre që ndodhën më 13 prill 1909, ta lërë Stambollin për të dytën herë.

## MËRGIMI I DYTË

Nga fillimi i vitit 1909 lufta midis partizanëve të Abdyl Hamitit dhe xhonturqve u ashpërsua në mënyrë të jashtëzakonshme. Të dy këto grupe politike përpiqeshin të përqëndronin në duart e tyre sa më shumë fuqi që të ishte e mundur. Ndikimi i xhonturqve në masat popullore gjatë shpalljes së Hyrjetit kishte filluar të dobësohej për shkak të moszbatimit nga ana e tyre të premtimeve që kishin dhënë. Këtë gjë u përpoqën ta shfrytëzonin për interesat e tyre partizanët e Sulltan Hamitit, të cilët, më 31 mars allaturka (13 prill) 1909, organizuan një kundërrevolucion dhe caktuan një qeveri të re, në të cilën mbizotëronin përkrahësit e regjimit të vjetër. Këto ngjarje krijuan një gjendje tepër të nderë dhe në këtë gjendje të nderë grupet kundërshtare u përpoqën të siguronin përkrahjen e Ismail Qemalit. Por Ismail Qemali nuk ju nënshtrua politikës së këtyre grupeve edhe ndoqi një politikë të pavarur të tijën, e cila kishte si pikësynim mbrojtjen e kushtetutës e të drejtave të kombit shqiptar. Pasardhësi i Hysen Hilmi Pashës, veziri i madh i ri Tefik Pasha i propozoi Ismail Qemalit Ministrinë e Drejtësisë dhe, në rast se s'i pëlqente kjo, atë të Punëve të Brendshme. Ismail Qemali i spinoi të dyja duke



thënë se dëshironte të vijonte punën e tij në parlament.

Po atë ditë, Ismail Qemalin e thirri Sulltan Hamiti në audiencë. Pas nëntë vjetve larg kryeqytetit të Turqisë, Ismail Qemali qëndroi ballë për ballë perandorit otoman të mbyllur vetë në kafazin e florinjte. Sipas kujtimeve të Ismail Qemalit, Sulltan Hamiti, pasi i shprehu keqardhjen për sa kishte ngjarë midis perandorit dhe Ismail Qemalit, tamam në çastin kur ishte i pakënaqur nga regjimi që ja kishte ngushtuar pushtetin, i tha se ishte shumë i gëzuar për ekzistencën e regjimit të ri, të cilin mendonte ta mbante me besnikëri, pasi e konsideronte tani si garantinë e vetme për lavdinë e tij personale dhe për të mirën e vendit. Sulltani i tha se që aq i bindur për dobinë e rendit të ri sa betohej për profetin e për kuranin që, edhe sikur populli i tij të vinte tani t'i binte ndër këmbë e t'i lutej ta merrte prapë fuqinë absolute në dorë, nuk do ta pranonte kurrësi, sepse besonte që kjo ishte përpjekja e fundit për të shpëtuar perandorinë, dhe se po ta sillte fati i keq që edhe kjo përpjekje të dështonte, atëhere vetë perandoria do të humbiste.

Këto fjalë dhe zotime të Sulltan Hamitit provojnë katërcipërisht se Ismail Qemali konsiderohej prej tij si një përkrahës i kushtetutës dhe kundërshtar i rivendosjes së rendit të vjetër, por edhe që nuk pajtohej plotësisht me politikën e xhonturqve. Tamam kjo pozitë e shtyri Ismail Qemalin të bënte në këtë kohë përpjekjen për të gjetur një *modus vivendi* që mund ta rriste autoritetin e partizanëve të tij.

Për këtë shkak, pra, nga pallati Ismail Qemali

shkoi drejt e në parlament, ku gjeti një numër të madh deputetësh të mbledhur në sallën e madhe, dhe atje u dha një raport mbi audiencën që pati me sulltanin dhe përsa bisëdoi me të. Ditën tjetër u thirrën gjithë deputetët në sesion të fshehtë, në të cilën Ismail Qemali u dha një ekspozë mbi gjendjen dhe u bëri apel për pajtim e bashkim. Pasi u bë kjo marrëveshje, deputetët mbajtën një miting publik, ku u adoptua një rezolutë me qëllim që çdo deputet t'u bënte telegram konstituentëve duke u njoftuar se si ndodhën ngjarjet dhe duke u dhënë sigurime se regjimi i ri do të ruhej.

Kjo «qetësi» dhe ky «pajtim» midis deputetëve me opinion të ndryshëm nuk zgjati shumë. Pas dy javëve një pjesë e ushtrisë së Selanikut, nën komandën e Mahmud Shefqet Pashës, e nxitur nga komiteti i xhonturqve, ju drejtua kryeqytetit. Kabineti i Teufik Pashës u rrëzua më parë se të niste nga puna dhe pushtetin e muarën xhonturqit. Ndërkaq miqtë e Ismail Qemalit e lajmëruan se një telegram i qe dërguar prefektit të policisë nga komanda e ushtrisë së Selanikut që të arrestonte deputetin shqiptar të Vlorës. Kur ushtritë e Mahmud Shefqet Pashës hynë në Stamboll, *Ismail Qemalit s'i mbeti gjë tjetër veçse të shpëtonte kokën.* U largua nga Stambolli në Evropë mbrëmjen e 17 prillit 1909. Në Athinë mori vesh për zbritjen e Sulltan Hamitit dhe hipjen e të vëllajt Mehmet Reshatit në fron të Turqisë, i cili s'ishte veçse një kukëll në duart e turqve të rinj, që e përdorën për të ndaluar revolucionin.

Në Stamboll, me gjithë përpjekjet e armiqve të tij për ta komprometuar Ismail Qemalin si nxitës të ngjarjeve të 13 prillit dhe si partizan të rivendosjes

së regjimit të vjetër, hetimet nuk nxuarën asnjë fakt kundër tij: prandaj parlamenti u detyrua të regjistronte një vendim *nonlieu* në dobi të Ismail Qemalit. Kështu, parlamenti rifilloi sesionet e tij, Ismail Qemali u kthye në Stamboll për të marrë pjesë në punimet e tij.

Për edhe pas kthimit të Ismail Qemalit në Stamboll, intrigat e xhonturqve vazhduan pa ndërprerje. Për të treguar se në ç'mënyrë xhonturqit përpiqeshin ta poshtëronin Ismail Qemalin me çdo lloj shpifjesh, tregojmë këtë incident që i ndodhi në parlament në këtë kohë. Në organin e Komitetit të xhonturqve «Xhonturku», u botua një artikull, në të cilin thuhej se drejtorit të Bankës Nacionale Sir Ernest Cassel, i cili po gjente vështirësira për të ngritur një hua, i kishin thënë se mjaft që t'i ofronte Ismail Qemalit 10.000, dhe do t'i vinte puna mbarë. Përveç karakterit shpifës, ky pohim bëhej edhe më qesharak, pasi Sir Ernesti nuk ndodhej në Stamboll në atë kohë, dhe ai jo vetëm që s'kishte nevojë për ndihmën e Ismail Qemalit, po kishte në Këshillin Administrativ të bankës vetë ministrin e financave dhe disa shefa të partisë xhonturke. Ismail Qemali kërkoi shpjegime nga redaktori, të cilin e detyroi t'i tregonte emrin e shpifësit. Në parlament Ismail Qemali mori leje të fliste mbi një çështje personale, dhe tha se në atë mbledhje të lartë nuk besonte të ndodhej ndonjë burrë aq budalla dhe frikacak sa të shpifte një përrallë të atillë. Por tek fliste ai, një farë Dr. Ismet (emrin e të cilit ja kishte dhënë dhe redaktori si trilluesin e shpifjes) u ngrit nga vendi dhe tha: «Unë e shtova atë paragraf në artikull».

Atëherë Ismail Qemali u përgjegj: «Pra qenke

ti frikacaku». Meqenëse kundërshtari nisi ta shante, Ismail Qemali, i zemëruar, e kapi për fyti dhe e flaku përdhé. «Na ndanë shpejt dhe Ismetin e qitën jashtë sallës. Mua më erdhi disi turp që në një çast zemërimi u kapa me grushte në pleqëri, po shumë nga miqtë e mi më lavdëruan, dhe thanë se Ismeti mori atë që meritonte».

Në fushën ekonomike, në këtë kohë ju paraqit parlamentit ligji mbi koncesionet e konventës për ndërtimin e hekurudhave në Anadoll. Ky ligj u jepte kartë të bardhë ministrave të akordonin koncesione pa kontrollin e parlamentit. Ismail Qemali e kundërshtoi aprovimin e këtij ligji. Vërejtjet që bëri Ismail Qemali suallën një furtunë mbi kokën e tij. Gjithë ministrat, së bashku me vezirin e madh, ju turën në vendin ku rrinte në parlament dhe, duke e kapur kush për duarsh e kush për rrobash, njëri nga deputetët xhonturq, Dervish Beu, e goditi prapa kokës. Në rrëmujë e sipër seanca u mbyll në mes të protestave të ashpra të miqve e të shumë deputetëve të tjerë.

Po atë mbrëmje, ai që e goditi e vizitoi Ismail Qemalin që t'i kërkonte të falur, por Ismail Qemali refuzoi ta harronte ngjarjen kaq lehtë dhe s'u kthye në parlament. Më vonë i vajti një deputacion i përbërë nga udhëheqës të ndryshëm parlamentarë, me Talahat Benë në krye, e vizitoi në hotelin që t'i paraqeste një lypë-ndjesë formale dhe ta përcillte në parlament në mënyrë solemne, ku pasi mori apolojinë e asamblesë zuri përsëri vendin e tij. «Për mua, personalisht, — tregon Ismail Qemali, — ky incident mori fund me kënaqësinë time të plotë, si nga ana e procedurës, ashtu edhe për arësye të sim-

patisë që m'u tregua nga gjithë anët, sidomos nga gjithë viset e Shqipërisë».

I përmendëm këto incidente, sepse qenë pasoja të asaj urrejtje të madhe që ndjenin xhonturqit për Ismail Qemalin, i cili paraqitej si një nga përfaqësuesit kryesorë të grupit të formuar në parlamentin turk nga deputetët e pakicave kombëtare joturke dhe të grupit të deputetëve patriotë shqiptarë.

Komiteti i xhonturqve tani ja kushtoi gjithë përpjekjet e tij forcimit të fuqisë, duke pasur për qëllim kryesor zhdukjen e elementëve kundërshtarë qoftë nga personat, qoftë nga kombësitë që do të kërkonin të pengonin ndikimin e tyre, kësisoj ata donin të sillnin në kontrollin e tyre edhe gjithë administratën financiare dhe ekonomike të vendit. Elementi etnik që xhonturqve u dukej më i fortë dhe më i rrezikshëm, qe populli shqiptar. Prandaj, «Asgjë, — tregon Ismail Qemali në «Kujtimet» e tij, — nuk u la mangët që mund të ngjallte turbullira, dhe u përdorën lloj-lloj masash represive me të vetmin qëllim që ta dërmonin atë që ata besonin se ishte koka e Medusës Nacionale».

Dhe duke përgjithësuar përvojën e tij rreth marrëdhënjeve të turqve të rinj me popullin shqiptar, Ismail Qemali, sikundër shkruan në artikullin e tij të gjatë «Shqipëria dhe shqiptarët» (botuar anglisht më 1917 në Quarterly Review). . . pat arritur në këtë përfundim: «Shqiptarët shpejt i zbuluan qëllimet e njëmendta të komitetit «Për bashkim e përparim», dhe panë humnerën që shtrihej midis kuptimeve politike të tyre dhe të programit të bashkimxhinjve turq. Me bashkim shqiptarët kuptonin grupin e racave të ndryshme nën flamurin e kushtetutës oto-

mane, e cila do të forconte perandorinë nëpërmjet bashkimit të të gjithë popujve të saj, duke i garantuar secilit ekzistencën e tij kombëtare. Komiteti në anën tjetër mendonte vetëm të bashkonte të gjitha racat e ndryshme duke i shtrënguar të mohonin origjinën e tyre dhe sa më shumë u forcohej pozita në pushtet aq më shumë u shtohej ambicja ta zbatonin këtë program».

## NË KRYENGRITJE TË ARMATOSUR!

Se sa i drejtë dhe i dobishëm ishte qëndrimi i rreptë dhe i papajtueshëm i Ismail Qemalit kundër xhonturqve, kjo u provua nga ngjarjet e mëvonshme, kur ata, pasi e patën shtënë në dorë pushtetin, i lanë pas dore ligjëratat mbi drejtësinë dhe lirinë dhe vunë në veprim dhunën! Ata u kujdesën sidomos të mposhtnin lëvizjen çlirimtare të shqiptarëve që ishte bërë pika më nevralgjike e perandorisë turke. Ministri i Brendshëm turk deklaronte në parlament se nuk ekzistonte një kombësi shqiptare. Verën e vitit 1909 ata vendosën taksa të reja të rënda për gjithë Shqipërinë. Në gusht po të këtij viti nxuarën ligjin mbi shërbimin ushtarak që detyronte muslimanë e të krishterë të shkonin në ushtrinë turke dhe e shtrinë këtë ligj edhe në ato krahina malësore që për shekuj ishin përjashtuar nga shërbimi ushtarak në Turqi. Qeveria xhonturke urdhëroi shqiptarët t'u dorëzonin armët autoriteteve turke, dhe dërguan kudo nëpunësit e tyre besnikë. Shkollat shqipe, gazetat e klubet u mbyllën njeri pas tjetrit. Patriotët shqiptarë ndiqeshin e burgoseshin. Mirëpo nuk pritej lehtë koka e «Medusës shqiptare». Gjithë masat e rrepta s'bënë gjë tjetër veçse ngjallën një valë të fuqishme zemë-

rimi dhe protestash në gjithë vendin; dhe pas tyre shpërtheu vullkani i kryengritjes shqiptare.

«Xhonturqit, — tregon Ismail Qemali në «Kujtimet» e tij, — që nuk shihnin në shqiptarët veçse një popull musliman, i cili s'mund të kishte tjetër ideal politik veçse të mos paguante taksa, besuan se, duke përdorur dhunën e shtypjen, do t'i bënin ata të butë dhe otomanë të bindur, dhe shembull për kombësitë e tjera. Duke vajtur me këtë shpresë, xhonturqit në më pak se dy vjet dërguan katër ekspedita ushtarake kundër kryengritësve shqiptarë. Por shqiptarët për shekuj me radhë i kishin rezistuar fuqisë së shumë perandorëve dhe nuk ishin nanuritur në gjumë as në kohën e Sulltan Hamitit, pra nuk u trembën as nga përpjekjet e xhonturqve. Përkundrazi politika agresive e xhonturqve që majë që ua ngjalli sentimentet kombëtare; sukseset që fituan ushtritë e Xhavitit e të Shefqetit aty-këtu mbi shqiptarët s'bënë gjë tjetër veçse ua ndezën flakë prushin e kryengritjes».

Ndërsa malësorët trima u bënin ballë me heroizëm sulmeve të hordhive turke në fushën e Kosovës dhe në grykat e Kaçanikut, dhe Xhavit Pasha e Shefqet Durgut Pasha hakmerreshin duke shkretuar Shqipërinë e Veriut me zjarr e hekur, në parlamentin turk një grusht deputetësh shqiptarë, me Ismail Qemalin në krye, çuan zërin e protestës, demaskuan barbarizmat e osmanllinjve, kërkuan me këmbëngulje pushimin e Xhavit Pashës, e këtij «katili e bishe të egër».

«Shqiptarët, — tregon përsëri Ismail Qemali, — entuziazmi i të cilëve kurrë nuk i shtyn përtej karakterit të tyre natyral, dhanë provën e pjekurisë së tyre politike edhe në këto çaste kritike. Ndërsa



gjaku i tyre ridhte lumë për mbrojtjen e të drejtave të tyre kombëtare, unë me kapacitetin e një udhëheqësi së bashku me shokët e mi shqiptarë bëra ç'ishte e mundur, si në seancat e parlamentit, si në mbledhjet private me ministrat, t'i bëja qeverinë turke dhe deputetët xhonturq të mblidhnin mendtë dhe të njihnin detyrën e tyre... Po gjithë këshillat e mia të sinqerta vanë kot».

Ismail Qemali, i cili tërë jetën e tij luftoi që edhe në Turqi të krijohet një regjim konstitucional parlamentar, dhe pas hyrjetit, u mundua që parlamenti turk të bënte sado pak për të zgjidhur hallet e popullit, kuptoi më në fund, siç e thotë vetë, se parlamenti ishte bërë «Foleja më e ndyrë nga e cila ata, xhonturqit, kryenin krimet kundër Shqipërisë»; prandaj kërkoi shpërndarjen e parlamentit. Ndërkohë figura e Ismail Qemalit ishte rritur para syve të popullit aq shumë sa ky njohu në të udhëheqësin e tij të vërtetë. Dhe Ismail Qemali pa se vendi i tij nuk ishte më në parlamentin turk, por në malet e Shqipërisë, ku valonte kryengritja.

Në këtë kohë ai kishte marrë atë raportin e imët nga «Hoxha i Ismail Qemalit», në të cilin i dërguari i tij i bënte një analizë vërtet të shkoqur mbi gjendjen e kryengritësve, të cilët e ftonin Ismail Qemalin sa më parë të vinte në mes të tyre si udhëheqësi i tyre i adhuruar.

Verën e vitit 1911 Ismail Qemali vajti në Cetinë të takohej me malësorët, që ishin arratisur me familjet e tyre në Mal të Zi përpara kërcënimeve të Shefqet Durgut Pashës. Me iniciativën e tij, atje në Gërçe, më 23 qershor, u organizua një mbledhje në të cilën u formulua i famshmi memorandum që mban emrin e vendit ku u shkrua. Në të dymbëdhjetë pikat

e këtij memorandumi paraqiteshin kërkesa të rëndësishme për mbrojtjen e interesave të të gjithë kombit shqiptar. Kryengritësit kërkuan që të njihej kombi shqiptar, që Shqipërisë t'i jepej autonomia territoriale dhe administrative, me një përfaqësues të sulltanit si inspektor të përgjithshëm për të kontrolluar zbatimin e urdhërave, t'i jepeshin garancira që të mos përsëriteshin veprime antikushtetuese, t'i jepej liri e plotë për të zgjedhur deputetët e vet, të lejohej hapja e shkollave dhe të emëroheshin nëpunës shqiptarë, të bëhej shërbimi ushtarak në vend, të përdorej për nevojat ekonomike e kulturele të vendit pjesa më e madhe e të ardhurave shtetërore, të zgjidheshin këshillat e përgjithshme në çdo vilajet, të cilat të vendosnin mbi buxhetin e çdo vilajeti e të kontrollonin shpenzimet, të shpërbleheshin nga ana e shtetit dëmet e shkaktuara fshatarëve tanë, t'i ktheheshin armët popullsisë dhe të shpallej një amnisti e përgjithshme.

Ky memorandum, i hartuar me inspirimin e Ismail Qemalit, pati rëndësi shumë të madhe politike, jo sepse në të u përfshinë kërkesa mjaft radikale, siç ishte veçanërisht kërkesa për autonomi territoriale dhe politike, por edhe sepse ai frymëzoi gjithë lëvizjet dhe kryengritjet e armatosura të shqiptarëve në Veri dhe në Jug më 1911-1912.

Prej Gërçes Ismail Qemali shëtiti nëpër Evropë. Së andejmi mbajti lidhje të ngushta me krerët e lidhjes shqiptare, të cilët i udhëzonte dhe i këshillonte vazhdimisht për veprimet e tyre, dhe kujdesej që hovi i lëvizjes kryengritëse të rritej sa më shumë. Vlerë të madhe ka fakti që Ismail Qemali i orientonte ata që ta shihnin lëvizjen çlirimtare të popullit shqiptar si të pavarur dhe të mos ja nënshtonin më opo-

zitës turke që në këtë kohë kishte marrë forca të mëdha.

Ismail Qemali ndërkohë zhvilloi nëpër Evropë një sërë bisedimesh me përfaqësues të shteteve evropiane për të sqaruar qëndrimin e tyre dhe mundësisht për të gjetur tek ata mbështetje për veprimet e ardhshme të tij. Duke kuptuar rrezikun e madh që i kanosej Shqipërisë nga zhvillimi i Luftës italo-turke (1911-1912) dhe nga përgatitjet që bënin shtetet ballkanike kundër Turqisë, Ismail Qemali tregonte se e vetmja rrugëdalje ishte kryengritja e përgjithshme në Shqipëri.

Për këtë qëllim, Ismail Qemali mori iniciativën të krijonte një qendër të vetme udhëheqëse jashtë vendit dhe me iniciativën e tij e të patriotëve të tjerë u vendos që të thirrej në qytetin Nisë të Francës një kuvend me përfaqësues të shoqërive të ndryshme shqiptare për t'i mbledhur fuqitë e për t'i drejtuar, siç shkruante Luigj Gurakuqi, «në një qëllim të vetëm».

Në dhjetor të vitit 1911 deputetët shqiptarë në Stamboll vendosën ta shfrytëzonin gjendjen e vështirë të Turqisë për t'ja shkëputur asaj të drejtat që kërkonte populli shqiptar. Ata i paraqitën kërkesat për reforma politike, ekonomike dhe kulturele në Shqipëri. U thirr urgjentisht edhe Ismail Qemali nga Nisa për të drejtuar luftën në parlament. Qeveria turke u kërcënua me një kryengritje të re në Shqipëri në rast se nuk plotësoheshin kërkesat shqiptare. Por xhonturqit e hodhën poshtë edhe këtë radhë memorandumit e deputetëve shqiptarë.

Nuk mbetej veçse një rrugë, ajo e kryengritjes për ta detyruar me armë qeverinë turke të njihte autonominë e Shqipërisë.

Në fund të dhjetorit 1911, me iniciativën e nën kryesinë e Ismail Qemalit, u organizua në Stamboll mbledhja e një grupi personalitetesh politikë shqiptarë, e cila vendosi të organizohej kryengritja e përgjithshme në Shqipëri. Ajo do të fillonte në Kosovë e pastaj do të përhapej në pjesën tjetër të Shqipërisë. U vendos të siguroheshin 15 mijë pushkë dhe një sasi të hollash për nevojat e kryengritjes. U ndanë detyrat midis pjesëmarrësve të mbledhjes. Ismail Qemali u caktua të siguronte armët dhe të hollat pranë qeverive që do të simpatizonin lëvizjen shqiptare.

Në vjeshtë, para se të fillonte lufta me Italinë, Ismail Qemali u dërgoi nga Nisa gjithë qendrave të kryengritjes shqiptare një qarkore, duke u treguar nevojën imperative të ishin gati për t'i bërë ballë çdo eventualiteti. Për këtë rol drejtues të Ismail Qemalit flet edhe letra e Fazill Toptanit, dërguar nga Parisi, më datë 13 tetor 1911, sipas udhëzimeve të Ismail Qemalit:

«Një letër që ju dërguam nga Nisa pa dyshim do ta keni marrë. Ajo letër që shkruar para se të fillonte lufta e Italisë. Tani punët gjenden shumë në rrezik. Po që se lidhim duart e rrimë si të vdekur dc të humbasim fare. Po ju, o zotërinj të ndershëm ç'prisni ende? Përgjigjen e presim me telegram që duhet ta shkruani kështu: «Gjendemi gati» — «S'mundim dot».

«Shqiptarët sot janë duke pritur nga ne një urdhër për të ngritur zërin e Shqipërisë dhe për të kërkuar të drejtat me armë në dorë. Një demarsh ndër mbretëritë e mëdha përpara kësaj kryengritjeje është i nevojshëm. Po s'bëmë gjë këtë herë Shqipëria na e puthi dorën dhe do të jesisim si jevgët në mes

të botës. Mendoni dhe bëni ç'lipset. Kjo është mendja dhe kërkimi edhe i plakut edhe i gjithë shqiptarëve kombëtarë. Ju lutemi mos flini dhe mos na lini pa përgjegje».

Kjo letër përfundonte me këtë shënim: «Kjo letër është shkruar me mua bashkë. Ju falem, Ismail Qemali».

Ndërkohë brenda perandorisë turke dhe veçanërisht në pjesën e saj ballkanike ishte krijuar një gjendje shumë e turbullt dhe e paqëndrueshme. Në këtë mes një rol me rëndësi të veçantë lojtën kryengritjet e vazhdueshme në Shqipëri. Nga fillimi i vitit 1912 u shpërnda parlamenti dhe u caktuan zgjedhje të reja. Menjëherë pas shpërndarjes së parlamentit Ismail Qemali u nis për një udhëtim në Evropë dhe, sipas marrëveshjes së mbledhjes së Stambollit, Hasan Prishtina u dërgua në Kosovë për të përgatitur një kryengritje të re. Xhonturqit përdorën gjithë mjetet për të mos lejuar zgjedhjen e deputetëve shqiptarë të opozitës si Ismail Qemalin, dhe ja arritën qëllimit duke krijuar një parlament, i cili, sikundër pohon Ismail Qemali, «Filloi lojën të merrte përsipër me një dorë atë që e pati dhënë një ditë më parë me dorë tjetër».

Prandaj krerët shqiptarë, me Ismail Qemalin në krye, pa ushqyer asnjë iluzion për këtë parlament të ri, vazhduan rrugën e luftës së armatosur.

Xhonturqit me kokëfortësinë e tyre të egër në përpjekjet për të gëlltitur kombësitë e vogla, ngjallën rezistencën tonë të pashmangshme dhe na detyruan të luftojmë për jetën tonë kombëtare. A nuk kishim pra të drejtë përmbi të gjitha të gjenim ne vetë udhën që do të na nxirrte në shpëtim? Kryengritja e përgjithshme dhe hyrja triumfale e krerëve të

të gjitha fiseve në Shkup i dha fund pushtetit të shfrenuar e kriminal të xhonturqve dhe shkaktoi shpërndarjen e parlamentit.

Pasi dërgoi një sasi armësh që mundi t'i siguronte në Evropë, Ismail Qemali së bashku me Luigj Gurakuqin, në mars të vitit 1912, shkuan vetë në Shqipëri që të përfundonin përgatitjet e kryengritjes së armatosur. Duke filluar nga mesi i prillit 1912, përpjekjet e armatosura të kryengritësve shqiptarë vazhduan pa ndërprerje, gjersa, më 17 korrik 1912, kabineti i turqve të rinj u detyrua të jepte dorëheqjen dhe qeverinë e re e formuan Ittilafistët. Më 6 shtator 1912 Ismail Qemali u nis nga Triesta për në Stamboll. Një letër e Luigj Gurakuqit na e bën të qartë qëllimin e tij: «Dy ditë përpara u takova me Ismail Qemalin, i cili u nis për në Stamboll ashtu si e kishim lënë fjalën në Fier. Atje do të mundohet t'i mbushë mendjen qeverisë se ne shqiptarët jemi shpëtimi i Turqisë, e të na nxjerrë nga ajo, në mos tjetër, njohjen zyrtare të kombësive e të gjuhës sonë pa të cilën nuk do të kemi as liri për shkollat, as të drejtën për shoqërirat tona.

Në këtë kohë Mali i Zi, Sërbia, Bullgaria dhe Greqia formuan Lidhjen Ballkanike për t'i shpallur luftë Turqisë. Duke qenë informuar mirë mbi këtë marrëveshje, Ismail Qemali kuptoi rrezikun që i turrej Shqipërisë dhe e quajti të domosdoshme të bëheshin veprime sa më të shpejta e të vendosnin për të mbrojtur çështjen shqiptare me fillimin e Luftës ballkanike. Në Stamboll nuk gjetën mirëkuptim në rrethet qeveritare turke, prandaj Ismail Qemali, sikundër shkruan në «Kujtimet e tija», u bind «Që pati ardhur koha për ne shqiptarët shpejt të merrnim masa të forta për shpëtimin tonë. Veziri-

i madh Qemal Pasha më nguste të qëndroja përkrah tij, dhe më ofroi portofolin e një ministrie. Në rrethana të tjera duhej ta kisha pranuar këtë post nderi me kënaqësi, po tani një detyrë më e lartë më shtrëngoi ta spinoja. Vendi im më nuk ishte atje, edhe shërbimet e mia ja kisha detyrë kryekëput atdheut tim». Ismail Qemali u nis për në Shqipëri.

Që më 1900, kur Ismail Qemali iku nga Stambolli dhe nisi korrespondencën e tij me patriotët e me qendrat shqiptare, për kaq vjet me radhë, nuk nisi atë rrugë që dc ta kthente në Turqi, po atë rrugë që do t'ja kthente Shqipërisë të birin e mërguar.

## DREJT 28 NËNTORIT


Para se të largohej nga Stambolli, Ismail Qemali u bëri vizita gjithë atyre shqiptarëve që mendonte se mund ta shoqëronin për në atdhe, vizitoi klubin e shqiptarëve edhe u foli anëtarëve të tij për çastin suprem të Shqipërisë, nuk harroi të vizitonte edhe shkollat ku e dinte se kishte ndonjë grusht studentësh me origjinë shqiptare. E kam të gjallë në mendjen time edhe vizitën që Ismail Qemali u bëri në këtë rast edhe studentëve shqiptarë në Robert Kolezh.

Në Robert Kolezh atë vit shkollor kishin ardhur afro njëzet studentë shqiptarë. Ne të vegjëlit, në kursin përgatitor, ishim në konflikt me drejtorinë, e cila na impononte turqishten për gjuhë amtare. Një pasdreke hyri në sallën e studimit një profesor dhe lajmëroi sa qenë shqiptarë të dilnin jashtë.

«Do të na përzënë,» — thamë, duke dalë prej dere.

Po jo. Profesori na porositi të venim në dhomën e gjumit, të laheshim e të ndërroheshim dhe të shkonim në sallën e pritjes. Këtu qenë mbledhur gjithë studentët e kolezhit, njëri prej të cilëve na tha të qëndronim me radhë dhe të rrinim urtë, se do të na vizitonte Ismail Qemali.





Populli grumbullohet për të dëgjuar aktin historik të shpalljes së pavarësisë

Emri i tij na ndezi kujtimet e së kaluarës. E kush nga ne s'e kishte dëgjuar këtë emër? Kush nga ata që s'e kishin parë nuk u gëzua për rastin që do të gjendej ballë për ballë me plakun e nderuar të Shqipërisë? Edhe sepse minutat na u dukën orë të tëra, kur po prisnim pa durim, dera u hap dhe te praku qëndroi një burrë.

Të gjithë rilindasit shqiptarë, Naum Bredhasi, vëllezërit Frashëri, Pashko Vasa, Koto Hoxhi, Themistokliu, Çerçizi, Spiroja, — kanë qenë jo vetëm të mençur e të mirë, po dhe shumë të bukur. Atë çast kur Ismail Qemali, qëndroi te dera e dhomës ku po prisnin, m'u duk si burri më i pashëm nga të gjithë rilindasit.

«Të gjithë shqiptarë?» — pyeti Ismail Qemali, duke kthyer kokën nga ata që e përcillnin. Dhe, duke hyrë, na dha dorën. Më në fund qëndroi në mes tonë dhe na tha:

«Mashalla! Mashalla! Sa gëzohem të shoh kaq shumë studentë shqiptarë në një shkollë. Po të ketë nga kaq dhe në të tjerat, Shqipëria shpejt do të ketë plot njerëz të mësuar. Djemtë e mi, keni dëgjuar se punët nuk venë mirë për vendin tonë. Ushtritë armike kanë hyrë në Shkup e po marshojnë drejt Manastirit... Po mos u dëshpëroni, ka perëndi dhe për Shqipërinë. Edhe Shqipëria do të bëhet shtet më vete. Po një shtet më vete ka nevojë për njerëz të ditur që ta qeverisin. Prandaj vështroni të mësoni... A keni ndonjë dëshirë?»

«Po! — i thamë ne më të rinjtë, — duam të vijë një mësues shqiptar për gjuhën shqipe...»

Pas disa ditësh, që fillimi i vjeshtës së prapsme, na erdhi mësuesi i shqipes, Sali Nivica. Përditë mësuesi ynë hynte në klasë, kokulur, i heshtur, i bren-

gosur dhe fillonte mësimin mengadalë dhe me kujdes. Vetëm një herë erdhi me nxitim, me fytyrë të qeshur. Sytë e zez e të bukur i shkëlqenin nga gëzimi:

«Vëllezër, gëzohuni! — thirri, duke na shikuar të gjithëve në fytyrë. — Ismail Qemali, delegatët, arrinë në Vlorë! Shpallën indipendencën e Shqipërisë! Rroftë Shqipëria e lirë!».

Po ç'history e gjatë, plot ankth e drithërimë për shqiptarët, për një popull të tërë përmbledhen në atë muaj që kur u nis Ismail Qemali nga Stambolli dhe gjersa arriti në Vlorë! Në udhëtimin e tij triumfal për në Shqipëri stacioni i parë për Ismail Qemalin qe Bukureshti, ku kishte një koloni të madhe shqiptare.

Ja teksti i procesverbalit të mbledhjes së kolonisë shqiptare në Bukuresht, që u mbajt nën kryesinë e Ismail Qemalit, më 23 tetor 1912: «Ismail Qemali e mori fjalën mbi gjendjen e sotme të Shqipërisë e mbi masat që duhet të marrin shqiptarët për të mbrojtur të drejtat e veta.

Vendimet që u muar janë:

1) Duke qenë se qeveria otomane ndodhet sot në pamundësi të mbajë administratën e vendit, duhet që shqiptarët të përmbledhin fuqitë e veta e të themelojnë një komitet drejtues, i cili të marrë në dorë qeverimin e vendit e të përpiqet që kombi shqiptar të mos dalë i mundur e të mos mbetet nën çdo pikëpamje prapa kombeve të tjera.

2) Të bëhet gati një komision prej shqiptarësh të ditur e të njohur që të dalin në Evropë ku të jetë nevoja për të mbrojtur në faqe të botës së qytetëruar e të qeverive të mëdha të drejtat kombëtare e vendore të popullit shqiptar.

3) Shqiptarët e Bukureshit, si kurdoherë kanë

qenë të parët në luftën kombëtare, të zgjedhin një komitet prej disa vetash, të cilët të jenë në lidhje me komitetin e brendshëm e me qendrat e tjera të shqiptarëve të jashtëm e të bëjnë atë që mundet për të ndihmuar e për të mbrojtur atdheun në ditët e sotme.

(Shënuar) *Ismail Qemali*  
*Luigj Gurakuqi*

Së andejmi Ismail Qemali telegrafoi në të gjitha anët e Shqipërisë të lajmëronin nisjen e tij nga Bukureshti, duke u thënë se pat ardhur çasti për shqiptarët të realizonin aspiratat e tyre kombëtare. Në të njëjtën kohë i porositi të dërgonin delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë në Vlorë, ku do të mbahej një kongres kombëtar. Në Budapest u takua me kontin Berthol, ministër i Punëve të Jashtme të Austrisë. «Ekselenca e tij i mirëpriti pikëpamjet e mia mbi çështjen nacionale dhe qe gati të më pranonte të vetmen kërkesë që i bëra, domethënë të më vinte në dispozicion një anije që do të më ndihmonte të arrija në skelen e parë shqiptare, pa ardhur ende ushtria serbe,» — tregon Ismail Qemali.

Më 12 nëntor 1912, duke ardhur nga Budapesti në Trieste, Ismail Qemali njoftonte telegrafisht bashkatdhetarët e tij në Shqipëri:

«Përpara të premtes jam atje. Mbledhja e përfaqësuesve në Durrës ose në Vlorë është krejt e nevojshme. I thirrni të gjithë. Gjersa të arrijmë mbani qetësinë e bashkimin. Çështja jonë politike u siguro fare».


Meqenëse Vlora qe blokuar nga flota greke,

Ismail Qemali dhe shokët e tij u gëzuan që mund të zbrisnin në Durrës. Atje panë se po i prisnin dy luftanije greke që patën ardhur një natë më parë, i bënë vaporit të tyre një shqyrtim të imët, gjatë të cilit nuk gjetën asgjë veç disa armëve, dhe i lanë të lirë të zbrisnin në skelë.

Popullsia e Durrësit nuk dinte asgjë rreth ngjarjeve të fuftës. Të gënjyer nga lajmet e pakta që arrinin në qytet përmes kanaleve të dyshimta, besonin se ushtria turke po dilte fitimtare, se kishte pushuar Filipopulin dhe po marshonte drejt Sofjes dhe Beogradit. As nuk dinin që serbët ishin përpara portave të qytetit të tyre. «Ardhja jonë, — tregon Ismail Qemali, — shkaktoi kureshtjen, që u ndrydh prej elementit turk dhe prej emigrantëve boshnjakë, të cilët përhapnin lajme se ne qemë agjentë provokatorë. Po kjo ndjenjë e veçantë lokale nuk e pengoi popullsinë e Durrësit dhe të krahinës të caktonte delegatët e saj për në Kongresin Kombëtar, të cilët u nisën gjithë bashkë për në Vlorë së bashku me togën e shqiptarëve nga Bukureshti».

Udhëtuan me kalë, dhe pa arritur në vendin e parë të çlodhjes, Ismail Qemali mori vesh se kryekomandanti turk i Janinës i kishte dërguar një urdhër telegrafik xhandarmërisë lokale që ta arrestonte Ismail Qemalin dhe ta shpinte në shtabin e ushtrisë turke. Prandaj delegatët shqiptarë shkuan udhë e pa udhë, nëpër baltrat e Myzeqesë gjersa më në fund arritën në Vlorë. Dhe poeti pyeste:

*Plak i gjorë e plak i mjerë,  
Ku do vejë — ku do bjerë?  
Nëpër erë e nëpër shira,  
Nëpër pellgje me shëllira...*



Me rastin e shpalljes së pavarësisë.

*Iku ditë e iku natë;  
I mungonte bukë e thatë,  
Edhe buka i mungonte,  
Vetëm zemra i vëlonte.*

## DITA E LAVDISHME

Vlora i priti delegatët me festë. «Një zjarr i shenjtë patriotizmi kishte pushtuar qytetin tim lindor, — tregon Ismail Qemali, — dhe entuziazmi i popullit dhe gëzimi na përshëndeti kudo. Në pak kohë u gjenda i rrethuar prej tetëdhjetë e tre delegatëve, muslimanë e të krishterë, të cilët erdhën nga gjithë ngastrat e Shqipërisë të pushtuara dhe të papushtuara prej forcave luftuese».

Më 28 nëntor 1912, në orën 2.30 pasdreke u hap Kongresi Kombëtar, në të cilën muarën pjesë përfaqësues të shtresave të ndryshme të popullit shqiptar. Në seancën e parë të tij, e mori fjalën i pari Ismail Qemali, i cili paraqiti gjendjen e Shqipërisë dhe përcaktoi masat e ngutshme që duheshin marrë. «Shqiptarët, — tha ai, — nuk e harruan as gjuhën, as kombësinë e tyre, dhe prova më e mirë janë përpjekjet dhe kryengritjet që bënë herë pas here, e sidomos në këto katër vjetët e fundit për të ruajtur të drejtat e zakonet e veta».

Ai theksoi se qeveria otomane nuk mori të gjitha masat e nevojshme për të kënaqur shqiptarët. Pas fillimit të Luftës ballkanike, fqinjët e Shqipërisë u muar vesh për copëtimin e ndarjen e Shqipërisë,



prandaj shqiptarët vrapuan të merrnin masat që lypte koha. E vetmja udhë shpëtimi, sipas patriotëve shqiptarë, është ndarja e Shqipërisë nga Turqia. «Për t'ja arritur këtij qëllimi, — shtoi ai, — unë ftova gjithë shqiptarët të mblidhen në Vlorë dhe jam i gëzuar që thirrja nuk vajti kot, po nga gjithë anët e Shqipërisë u dërguan delegatë që të bisedojnë e të kujdesen së bashku për shpëtimin e atdheut. Masat e para dhe të nevojshme që duhet të marrë sot kombi shqiptar, janë këto: Të bëhet Shqipëria më vete me një qeveri të përkohshme; të zgjidhet një pleqësi për ndihmë e kontroll të qeverisë; të dërgohet një komision në Evropë për të mbrojtur çështjen shqiptare përpara mbretërive të mëdha».

«Populli shqiptar, — deklaroi Ismail Qemali, — na zgjodhi dhe na dërgoi neve në këtë mbledhje që të këshillohemi për shpëtimin e atdheut. Shpëtimi është një i vetëm: Liria. Prandaj duke u mbështetur mbi dëshirat e shenjta dhe me vullnetin e patundur të të gjithë popullit, ne përfaqësuesit e tij e shpallim Shqipërinë më vete, të lirë e të pavarur».

Të gjithë delegatët, pasi aprovuan fjalët e Ismail Qemalit, vendosën njëzëri që «Shqipëria që sot të bëhet më vete e lirë dhe e pavarur».

Pasi u aprovua kjo deklaratë që shpalli pavarësinë e Shqipërisë, u vendos të ngrihej flamuri.

«Pastaj u pezullua seanca dhe delegatët lanë sallën për të ngritur mbi shtëpinë time ku linda vetë dhe ku patën rrojtur stërgjyshërit e mi, në mes të brohorirave të mijëra njerëzve, flamurin e lavdishëm të Skënderbeut, që pati fjetur i mbështjellë në palët e tija për katërqind e dyzet e pesë vjet me radhë. Kurrë nuk do ta harroj atë çast, dhe duart m'u dro-

dhën ne shpresë e krenari tek e ngula në ballkonin e banesës së vjetër shtizën me flamurin e prijsit të fundit të Shqipërisë. U duk sikur shpirti i Heroit të pavdekshëm kaloi në atë çast si një zjarr i shenjtë përmbi kryet e popullit».

Përpara popullit, që nga ballkoni, Ismail Qemali mbajti këtë fjalim:

«Vëllezër shqiptarë!

«Oh, sa të lumtur që e ndjej veten sot, që shoh, këtu në Vlorë, kaq burra shqiptarë të mbledhur së bashku duke pritur me kureshtje e padurim përfundimet e kësaj mbledhjeje historike për fatin e atdheut tonë të dashur».

«Plot me gaz e me lot në sy, nga mallëngjimi, pra, po dal këtu para jush që t'ju gëzoj me sihariqin e madh, se sot edhe këtë minutë, kongresi shpalli mëvetësinë e Shqipërisë, duke lajmëruar gjithë botën mbarë për këtë punë e duke më ngarkuar mua kryesinë e qeverisë së përkohshme të Shqipërisë së lirë».

«Posi ëndërr më duket ky ndryshim i madh në vendin tonë që hoqi e vojti të zezat e ullirit pesëqind vjet me radhë nën sundimin turk, po që tani në kohët e fundit ishte gati të jepte shpirt, për gjithnjë, të shembej e të shfarosej krejtësisht nga faqja e dheut kjo Shqipëri që dikur shkëlqente nga trimëria e pashoqe e bijve të saj, kjo Shqipëri që kur i kërcënohej rreziku Evropës nga pushtimet e Turqisë, nën kryetrimin e pavdekshëm të saj, Skënderbeun, u bë porta e hekurtë kundër sulmeve të tërbuara të sulltanëve më të egër që ka pasur Turqia».

«Mirëpo, desh zoti, që me punën, me trimërinë dhe guximin e pashoq të shqiptarëve sot e tutje të marrin fund mjerimet e vuajtjet e atdheut tonë,

sepse këtu e tutje, jemi të LIRË të PAVARUR dhe MË VETE, prandaj qeshni dhe gëzohuni!

«Për t'ja arrijtur kësaj dite të bardhë e të madhe, na ka ndihmuar gjaku i dëshmorëve dhe puna e vlefshme e patriotëve tanë dhe e të gjithë shokëve që muarën pjesë në këtë mbledhje dhe e të gjithë juve, që tani po ju gufon zemra nga gazi i madh që ndjeni; mirëpo, mbledhja, si më plak që jam, më ngarkoi mua ngritjen e shenjtë të shenjës sonë kombëtare, të flamurit tonë të nderuar e të dashur».

«Populli posa sheh flamurin që ngrihet në shtizë, shpërthen në brohoritje e gëzim me zë të lartë: Rroftë flamuri! Rroftë Shqipëria e lirë!!».

«Ja, pra, ky është FLAMURI YNË! I kuq e me shqiponjë dykrenore në mes. Dhe tani, të gjithë bashkë, si një trup i tërë dhe i pandarë, le të punojmë për ta mburuar, për ta përparuar e për ta qytetëruar, si i ka hije, atdheun tonë të LIRË».

«Duke përfunduar, s'më mbetet gjë, veçse t'i drejtoj një lutje Zotit të madh, që, bashkë me bekimet e tij që i lyp të na japë, për të qenë të denjë të kësaj dite, të pranojë që këtej e tutje të jem unë dëshmor i parë i atdheut, ashtu si pata nderin e fatin që të jem i pari ta puth e ta bëj të valavitet i lirë flamuri ynë në atdheun tonë të Lirë.

«Rroftë flamuri! Rroftë Shqipëria!»

Me të rifilluar seanca e kongresit përsëri, Ismail Qemali u zgjodh president i qeverisë provizore me porosi që të formonte kabinetin. Ismail Qemali e quajti të përshtatshme që edhe ministrat të zgjidheshin prej kongresit, dhe ruajti për vete të drejtën të ndante portofolet. Me t'u formuar qeveria, ko-

gresi zgjodhi tetëmbëdhjetë anëtarë që do të formonin Senatin.

Që ditën e 28 Nëntorit pasdreke, Ismail Qemali u drejtoi qarqeve dhe qyteteve telegramin që vijon:

«U pa nevoja të shpallet pavarësia e Shqipërisë nga shkak i keqësimit të gjendjes së sotshme. Për tani çdo shqiptar do të mbajë qetësinë, do të ruajë bashkimin njëri me tjetrin do të rrojë si vëllezër me të gjithë, qofshin turq, qofshin të huaj, ose nga çdo element tjetër. Të forcohet harmonia dhe rojtja si vëllezër: këtë ta kemi si një detyrë njerëzore dhe politike. Imponohet nga gjendja që populli të mbajë qëndrim të ndershëm e të qetë. Këtë gjë lus prej popullit të ndershëm, përndryshe do të jepen dënimet më të rrepta kundër guximtarëve pas kësaj shpalljeje».

Pas shpalljes së pavarësisë, Ismail Qemali e quajti për detyrë të dorës së parë ndalimin e pushimit të tokave shqiptare prej forcave serbe dhe greke, të cilat ishin futur thellë në viset e Shqipërisë. Nga njëra anë, ai u drejtoi protesta të ashpra qeverive serbe e greke dhe, nga ana tjetër, udhëzonte autoritetet shqiptare të merrnin masa urgjente për të ndaluar me çdo mënyrë marshimin e ushtrive të huaja. Me dyzina janë aktet politike që ka shkruar e nënshkruar vetëm ditën e shpalljes së pavarësisë. Kur lexon të gjitha shkresat e tija — shembulla qartësie dhe stili — të pregatitura prej dorës së tij me kujdes e ditë për ditë, çuditësh nga veprimtaria e palodhur e plakut shtatëdhjetëvjeçar!

Krijimin e shtetit të ri Ismail Qemali ua lajmëroi Fuqive dhe Portës së Lartë me telegramin që vijon:

«Asambleja Kombëtare, përbërë nga delegatë

prej gjithë viseve të Shqipërisë, pa dallim feje, që u mblodh sot në qytetin e Vlorës, proklamuan pavarësinë politike të Shqipërisë dhe formuan një qeveri provizore të ngarkuar me detyrën që të mbrojë të drejtat e popullit shqiptar, të kërcënuara me shfarosje nga ushtritë serbe, dhe të çlironin tokën kombëtare të invaduar nga forcat e huaja. Duke sjellë këtë fakt në dijeninë e ekselencës tuaj, kam nderin të kërkojmë nga qeveria e Madhërisë së tij Britanike ta njohë këtë ndryshim në jetën politike të kombit shqiptar».


«Shqiptarët që hynë në familjen e popujve të Evropës Lindore, ndër të cilët mburren se janë më të mocmit, ndjekin një qëllim të vetëm, të rrojnë në paqe me gjithë shtetet e Ballkanit dhe të bëhen element ekulibri. Ata janë të bindur që qeveria e Madhërisë së tij, sikundër edhe gjithë bota e qytetëruar, do t'i mirëpresin duke i mbrojtur nga sulmet kundër ekzistencës së tyre kombëtare dhe kundër çdo cungimi të atdheut të tyre».

Porta e Lartë, përnjëherësh, me të mësuar lajmin e pavarësisë së Shqipërisë, mori qëndrim të kundërt me aspiratat e shqiptarëve. Veziri i madh, në një telegram përgjigje notës së Ismail Qemalit protestoi për pavarësinë e Shqipërisë dhe pyeste: «Në ç'fuqi do të mbështetej Shqipëria? Në Austrinë? Në Italinë? Le të mos harrojë Shqipëria, shtonte veziri, shëmbullin e Krimesë, për të cilën independenca nën mbrojtjen e Rusisë s'ishte veç paraloja e robërimit të plotë». «Përgjegjja ime që se Shqipëria nuk mbështetej as në Austrinë e as në Italinë, — thotë Ismail Qemali, — po në të drejtat e shqiptarëve të ekzistonin e të kishin kombësinë e tyre. sikundër edhe në detyrat e Fuqive të Mëdha të res-

pektonin kombësitë. Shtova që Turqia që një avukat i keq i kauzës së kombësive të lira, dhe që Shqipëria do të preferonte ta mbronte kauzën e saj vetë».

Me gjithë këtë qëndrim të keq të Portës së Lartë dhe kërcënimit të ushtrive turke që ende qëndronin në disa pjesë të Shqipërisë, qeveria provizore e përdori kohën për të organizuar administratën dhe për të mbajtur rregullin në krahinat që kishin mbetur të lira. Heshtja e Fuqive të Mëdha dhe indiferentizmi i tyre ballë invazionit serb edhe shkretimit në viset shqiptare, po në të njëjtën kohë bllokada dhe bombardimet që i bënin grekët qytetit të Vlorës dhe bregdetit e bënin gjendjen të vështirë. Pak më vonë, kur flota greke preu kabllon që ishte kanali i vetëm i komunikimit të qeverisë me botën e jashtme, Vlora u izolua fare edhe mbeti pa njoftime përsa ngjisnin përtej kufive shqiptare.

Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë, më 28 Nëntor 1912, është kurorëzimi i gjithë përpjekjeve pesëqindvjeçare të popullit shqiptar. Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë është edhe kurorëzimi i punës patriotike të Ismail Qemalit. Ndërkaqë mund të themi se Shqipëria vërtet u shpall e pavarur, po pavarësia e saj ende nuk ishte siguruar. Prandaj plaku shtatëdhjetëvjeçar, duke mos u trembur nga gjithë vështirësitë e jashtme si edhe të brendshme, që shumëkujt i dukeshin të pakapërcyeshme, ju përvesh punës për ta siguruar këtë pavarësi. Besimi i Plakut të Vlorës çeli besimin në zemrat e gjithë patriotëve dhe u dha forcë për ta mbrojtur Shqipërinë e lirë.



Ismail Qemali me Isa Boletinin.

## NË KRYE TË QEVERISË PROVIZORE

Vetëm kur njohim mirë gjendjen e vështirë të Shqipërisë në kohën e ngritjes së flamurit, mund të kuptojmë vlerën e madhe të përpjekjeve që bëri Ismail Qemali në krye të qeverisë provizore për të siguruar e ruajtur lirinë e vendit tonë. Asnjë nga Fuqitë e Mëdha të Evropës nuk ja dha dorën popullit shqiptar në këto çaste kritike. Kjo u duk e qartë në qëndrimin që mbajti Konferenca ndërkombëtare e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha që filloi punimet e saja në dhjetor të vitit 1912 në Londër. Në Paris e në Petrograd qarqet zyrtare u shprehën hapur se Franca dhe Rusia nuk do të duronin kurrë krijimin e një «Turqie të vogël» në Ballkan! Dhe sa për Italinë dhe Austrinë politika e tyre imperialiste u duk gjatë Luftës së parë botërore dhe me ngjarjet që pasuan këtë. Qeveria e Vlorës qysh në fillim të dhjetorit caktoi delegacionin që do të shkonte në Londër për të mbrojtur çështjen shqiptare me këtë program: Njohja e pavarësisë së Shqipërisë; vendosja e një regjimi monarkik konstitucional; caktimi i mbretit nga Evropa sa më shpejt; caktimi i një komisioni për kufitë e Shqipërisë, të cilat sipas kërkesave të qeverisë provizore, duhet të përfshi-



nin, Shkodrën, Pejën, Mitrovicën, Prishtinën, Shkupin, duke ruajtur në jug si kufi vijën që përfshinte edhe vilajetin e Janinës.

Por Konferenca e Londrës nuk i mori parasysh aspak kërkesat e qeverisë shqiptare. Përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha e përdorën Shqipërinë si një mjet suplimentar për konjunkturën e tyre politike dhe vendimet e herëpashershme, që mori Konferenca e Ambasadorëve, s'bënë veçse dëmtuan interesat e Shqipërisë. Për shtetet evropiane interesat e fqinjëve të Shqipërisë qëndronin më lart se të drejtat e popullit shqiptar. Ndërsa Fuqitë e Mëdha bënë pazarllëqe në kurriz të Shqipërisë, fqinjët ndehnin kthetrat e tyre mbi viset shqiptare. Flota greke kishte bllokuar edhe vetë Vlorën, ushtria e Kostandinit ishte shtrirë nga Llogaraja në Tepelenë gjer në Skrapar e Gorë. Ushtritë serbe, duke shkatëruar dhe masakruar ç'gjenin përpara, kishin zbritur gjer në Elbasan e Durrës. Edhe ushtria turke, nën komandën e atij Xhavit Pashës, që katër vjet më parë e kishte mbytur Kosovën në gjak e zjarr, tani e shpartalluar dhe e ndjekur prej ushtrive ballkanike këmba-këmbës, po i kërcënohej kryeqytetit provizor të Shqipërisë.

Çfarë pune titanike e zotësi të rrallë duhej të kishe që të përballoje këto kërcënime që i turreshin Shqipërisë nga të katër anët. Ne e kuptojmë fare mirë se sa e dobishme ka qenë në ato çaste zotësia, përvoja dhe urtësia e Ismail Qemalit, i cili u përpoq të shfrytëzonte gjithë kontradiktat në gjirin e armiqve të Shqipërisë, të zbulonte e të demaskonte intrigat e tyre djallëzore dhe të përfitonte ç'mund të përfitohej. Madje Ismail Qemali e quajti të nevojshme që të shkonte vetë në Londër.

Më 1 prill 1913 Ismail Qemali u nis për udhëtim në Evropë që të bisedonte me Fuqitë e Mëdha në Romë, Vjenë, Paris e Londër.

Objekti i udhëtimit të tij që të luftonte për kauzën e integritetit tokësor të Shqipërisë, në Londër, ku konferenca po jepte e merrte për të vendosur çështjen e Ballkanit. Ismail Qemali gjithashtu dëshoi të shpejtonte zgjedhjen e sovranit të ardhshëm, i cili do të ndihmonte për të siguruar stabilitetin e qeverisë kombëtare dhe të mërgonte pjesërisht vësh-tirësitë e brendshme që i lindnin një qeverie pro-vizore.

Në Vjenë konti Berhtold, në bisedën e tij të parë me Ismail Qemalin, u përpoq t'i mbushte mendjen se sa e paktë që shpresa për Shqipërinë të shpëtonte tërësinë e saj tokësore. «Kjo që dacka e parë plot dhimbje për mua, po më e keqja do të vinte pastaj, sepse ditën që lashë Parizin për në Londër erdhi lajmi i rënjes të qytetit të Shkodrës në dorë të Esat Pashës e të malazezve. Kjo mynxyrë që ngjau ndër-sa flota e gjashtë e Fuqive të Mëdha po manovronte në afërsitë e këtij qyteti që të shtrëngonte Knjaz Nikollën ta ngrinte rrethimin, vuri në rrezik tërësinë dhe pothuajse vetë ekzistencën e Shqipërisë». Në Konferencën e Londrës Ismail Qemali i kushtoi vëmendjen e tij më të madhe çështjes së tërësisë tokësore të Shqipërisë, duke lënë në plan të dytë çështjen e kandidaturës së fronit të Shqipërisë. Ja si na e përshkruan në «Kujtimet e tija» Ismail Qemali përfundimin e mbledhjeve të Konferencës së Londrës: «Nga gjithë çështjet ballkanike të shqyr-tuara në këtë konferencë, pas mendjes sime, më e para, më e ngutshmja dhe më interesantja, e mbi të gjitha, më evropjanja që ajo e Shqipërisë. E quaj-

ta të mundur të shpresoja që një popull kaq i denjë të çmohej për shkak të lashtësisë së tij, të trimërisë së tij dhe të shërbimeve që i kishte sjellë Evropës (së pari duke e mbrojtur atë kundër invazionit turk, dhe pataj duke ju bindur fatit që të bëhej kurban për paqen dhe ekuilibrin evropian), mund të ishte lejuar të bëhej zot në shtëpinë e vet e të gëzonte independencën e plotë kombëtare. Shqiptarët, të çli-ruar nga zgjedha turke, nën të cilën patën lënguar për shekuj, do të kishin qenë të lumtur të fitonin lirinë dhe pavarësinë e tyre, dhe çlodhjen për të cilën kishin nevojë kaq të madhe. Nuk kishim të tjera kërkesa të bënim, të tjera pretendime të parashtro- nim. Shqiptarët dëshironin, që puna e restaurimit të ngjiste për gjithë popujt ballkanikë sikundër edhe për ata vetë, urrejtja e smiri të merrnin fund, të drejtat legjitime të bëheshin të shenjta, dhe çdo ambicje dhe ndër marrje e padrejtë të haste dëni- min e saj në një garanci solidariteti nga ana e Fu- qive të Mëdha. Të sigurtë për drejtësinë e kërkesat tona, pritëm në besim të plotë vendimin e Konfe- rencës së Fuqive.

Por simpatia që më treguan për misionin tim që i vetmi ngushëllim për zemrën e thyer të Shqipërisë kur mësuam vendimin e konferencës së Londrës. Më shumë se gjysma e atdheut shqiptar i që dhënë Sërbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Qytetet më të lu- lëzuara dhe viset më pjellore të vendit tonë qenë shkëputur dhe Shqipëria ishte zvogëluar në pjesët e saja më malore dhe më të thata. Të zhytur për- sëri në depresionin e thellë, tek shihnim të errësuar të ardhmen e vendit tonë të rilindur, na ngushëllo- nin vetëm duke na thënë se qemë bërë kurban për interesat e përgjithshme të Evropës! I pajtuar me

fatim po jo i dëshpëruar, u ktheva në Shqipëri i frymëzuar vetëm nga shpresa që rrethana më të favorshme në të ardhmen do t'i jepnin rastin Shqipërisë të realizonte dëshirat e saja legjitime».

Ismail Qemali u ktheu në Vlorë në qershor të vitit 1913, i ngarkuar me gjithë hallet që ja imponuan Shqipërisë shtetet imperialiste. Po sikur të mos mjaftonte gjithë kjo mynxyrë e shkaktuar prej armiqve të jashtëm, pashallarë e bejlerë, që s'e kishin për atdhe Shqipërinë, u vunë në shërbim të armiqve të huaj për t'ja ngulur nga prapa edhe më thellë thikën e tradhëtarit nënës së tyre.

Esat Pashë Toptani, Prenk Bib Doda, Dervish be Biçakçiu, Kristaq Zografi, etj., me veprimet e tyre antikombëtare e kishin vënë në rrezik tërësinë tokësore dhe shkaktuan çrregullim e rrëmuje në të gjithë Shqipërinë, duke i kundërshtuar me çdo mjet përpjekjet e qeverisë provizore për vendosjen e rregullit e për ruajtjen e pavarësisë. Po nuk ishin vetëm këta që i prishnin punë dhe e luftonin qeverinë e Vlorës. Kishte edhe të tjerë që, ndonëse u ishin besuar ofiqe të larta në shtetin e ri prej vetë Ismail Qemalit, kur ua donte interesi i tyre vetiak a klasor, i hidhnin gjemba nëpër këmbë të gjorit plak që ta pengonin në punën e tij të shenjtë.

Në një kohë kur vetë ekzistenca e shtetit shqiptar ishte në rrezik, Myfit Libëhova, ministër i Punëve të Brendshme (kur Ismail Qemali propozoi Luigj Gurakuqin në komisionin ndërkombëtar të kontrollit), i ofenduar në qibrën e beut që u krahasua me një harbut, nuk diti të përdorë argument më dinjitoz se sa t'i dërgonte Ismail Qemalit këtë letër:

«Ju ftoj Naltësinë Tuaj të ndiqnin rrugën e

ndërgjegjes e të njerëzillëkut dhe të na paguani borxhet që na detyroheni me dëftesë e pa dëftesë».

Kjo letër e përfaqësuesit të bejlerëvet në qeverinë provizore tregon më së miri se sa e zhveshur ka qenë kjo klasë feudale nga idealet patriotike dhe sa të vështirë e pati Ismail Qemali punën kur rreth tij kishte aq shumë nga këta tipa.

Sidoqoftë qeveria provizore, nën udhëheqjen e Ismail Qemalit, bëri mjaft përpjekje për të vendosur rregullin e qetësinë, për të krijuar administratën, për të organizuar vendin dhe për t'i bashkuar shqipëtarët.

Nga ana tjetër populli i thjeshtë në çdo rast u vu nën urdhërat e Ismail Qemalit dhe i dha çdo përkrahje. Vetë Ismail Qemali në «Kujtimet e tij» pohon se pikërisht virtytet e larta të popullit shqiptar dhe përkrahja që pati prej tij ishin shkaku që siguroi çdo sukses të qeverisë që kryesoi: «Qe për hir të virtyteve të kësaj race në atë vend ku kufitë ende s'ishin caktuar, ku statutet politike të zotuarra prej Evropës prisnin të plotësoheshin dhe ku një propagandë e çmendur po zbatohet nga të huajt me qëllim që të provokohej rrëmuja, që për hir të këtyre virtyteve që qeveria ime mundi t'i sigurojë shtetit qetësinë dhe administratën normale», — shkruan Ismail Qemali.

Meqenëse një ndër vendimet e Konferencës së Ambasadorëve ishte edhe caktimi i sovranit, çështje që kishte mbetur e pazgjidhur dhe po zvarritej nga Fuqitë e Mëdha, dhe duke shpresuar se ardhja e sovranit mund të konsolidonte pavarësinë e vendit, Ismail Qemali u bëri në këtë kohë Fuqivet të Mëdha një apel të ngutshëm për ta zgjidhur sa më shpejt këtë çështje:

«Në goftë se qeveria provizore e Shqipërisë, e cila për njëmbëdhjetë muaj është përpjekur në vështirësira të panumërta, ka mundur të mbajë rregullin dhe qetësinë relative në një vend të trazuar nga gjithë anët prej armiqsh që janë betuar ta prishin, ajo nuk e kërkon për vete meritën që në fakt i përket vetëm patriotizmit dhe shpirtit paqëndashës të popullit shqiptar».

«Porse kjo gjendje provizore e punëve nuk mund të vazhdojë përgjithmonë pa u ndeshur në vështirësi të pakapërcyeshme. Besojmë se kemi arritur kufinë ekstreme të durimit të popullit, dhe nxitojmë t'i parashtrijmë konsideratës së qeverisë dëshirën unanime të popullit dhe të qeverisë për emërimin e fronëzimitin e sovranit, prania vetë e të cilit do të mjaftojë të bashkojë gjithë klasat e popullit në punë për të konsoliduar Shqipërinë dhe për të organizuar administratën e saj.

Me shpresë që fuqitë garantuese do të marrin në shqyrtim serioz kërkesën tonë, qeveria provizore është gati të hedhë çdo çap të nevojshëm për të shpejtuar rezultatin e lumtur, të cilin shqiptarët e presin me padurim».

Pak kohë pasi u dërgua ky telegram, Fuqitë e Mëdha arritën në marrëveshje për zgjedhjen e Princ Vidit si mbret të Shqipërisë.

Po Princi nuk po dukej.

Ndërkaq turqit e rinj në Shqipëri dhe oficerët turq të kthyer nga Shkodra me Esat Pashën e përdorën këtë kohë për të nisur një fushatë të egër në dobi të një princi turk, ndërsa grekët dhe sërbët në vendet e pushtuara po e shtonin kaosin.

Qeveria e kryesuar nga Ismail Qemali u gjend

e sulmuar nga një varg intrigash të elementëve reaksionarë feudalë, përfaqësuesit e të cilëve në qeveri, duke filluar nga shtatori i vitit 1913, dhanë dorëheqjen njëri pas tjetrit. Ndërsa këta elementë u zëvendësuan nga patriotët demokratë, vështirësitë që haste qeveria e Ismail Qemalit brenda vendit nga forcat reaksionare nuk u pakësuan. Përkundrazi, gjendja u bë edhe më e vështirë nga qëndrimi i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, që pati ardhur në tetor në Shqipëri dhe që e kundërshtonte vazhdimisht veprimtarinë e qeverisë së Vlorës, aq sa Ismail Qemali u detyrua publikisht të shprehte pakënaqësinë e qeverisë drejt veprimeve të komisionit, që e gjymtonin pavarësinë kombëtare: «Qëllimi i Evropës nuk mund të ketë shkak vetëm të mirëtonë, — deklaroi Ismail Qemali, më 22 tetor 1913, përpara një mitingu në Vlorë, — po një kontroll sado i zbutur dhe i zbukuruar të quhet, duke qenë që vjen prej mendimit që kanë bota për pamundësinë e shqiptarëve të qeverisin vetë, na jep ndjenjën se s'janë fort të kënaqshme për shqiptarin që do lumtërinë morale të Shqipërisë».

Duke kufizuar veprimtarinë e qeverisë së Vlorës dhe duke përkrahur intrigat e shteteve kapitaliste dhe të feudalëve reaksionarë, komisioni ndërkombëtar i kontrollit, që haste në kundërshtimin e Ismail Qemalit, u përpoq të diskreditonte kryetarin e qeverisë provizore të Shqipërisë dhe madje ta mënjanonte krejtësisht. Në këto rrethana u bë e pamundur veprimtaria e qeverisë së Vlorës. Prandaj Ismail Qemali u detyrua t'ja dorëzonte pushtetin Komisionit të Kontrollit. Si rezultat i marrëveshjes që u arrit u nënshkrua ky protokoll:

«Sot më 22 janar 1914, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit u mbledh në prezencën e shkëlqesisë së tij Ismail Qemal beut. Presidenti i qeverisë provizore, i bindur se mënyra për t'i dhënë fund gjendjes së përçarjes dhe të anarkisë është të formohet një qeveri e vetme për të gjithë Shqipërinë, dhe që në rrethanat e tanishme ky qëllim mund të arrihet po të vendoset pushteti në duart e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit në emër të Fuqive të Mëdha, ka përsëritur kërkesën që i pati bërë më përpara Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, në prezencën e ministrave, të marrë përsipër këtë detyrë dhe të pranojë vendosjen e fuqisë në duart e tyre. Komisioni Internacional i Kontrollit i shfaqti nderimet e duhura për ndjenjat patriotike që kanë diktuar veprimet e ekselencës së tij Ismail Qemal beut, pranoi këtë delegim të Fuqisë dhe, të autorizuar nga Fuqitë e Mëdha marrin përsipër administrimin e Shqipërisë në emër të qeverisë që përfaqëson. — Vlorë, 22 janar 1914».

Pas këtij akti të fundit, Ismail Qemali e la ndërtesën presidenciale ku qenë zyra dhe shtëpia ku banoonte dhe ku mbledhej Këshilli i Ministrave, dhe shkoi me karrocë nga skela në qytet. Si zuri vend në tryezën në mes të sallës, ku ishin mbledhur edhe një pjesë e ministrave, Ismail Qemali shkroi telegramin e fundit, me të cilin i thoshte popullit shqiptar «Lamtumirë!»:

«Pushtetin shtetëror që më dorëzoi Asambleja Kombëtare, e cila shpalli pavarësinë e Shqipërisë, kam tamam 14 muaj që e ushtrova me gjithë të metat e mia, duke u përpjekur pa mos humbur asnjë çast për të përgatitur elementët me qëllim që t'i



sigurojë atdheut bashkimin kombëtar dhe tërësinë tokëscre».

«Do të ushqej gjersa të jem gjallë ndjenja mirënjohjeje kundrejt gjithë atyre miqve e shokëve të qendrës e të krahinave, të cilët më ndihmuan me bashkëpunimin e tyre».

«Meqë disa ngjarje të hidhura janë shfaqur në disa anë, të shtytura nga ambicja dhe interesi vetiak, dhe kanë trubulluar harmoninë qeveritare, për të cilën atdheu ynë ka gjithnjë nevojë, sidomos sot kur ndodhet në një gjendje shtetërore të tronditur, çështja kombëtare u rrezikua shumë».

«Pra është nevojë e domosdoshme që këtyre ngjarjeve të hidhura t'u jepen fund dhe kjo nevojit formimin e një qeverie të njëshme, të fortë dhe autoritare, realizimi i së cilës si një detyrë patriotike më përkiste mua».

«Për këtë arsye bëra një demarsh para Fuqive të Mëdha, të cilave u propozova që derisa të vijë mbreti i Shqipërisë, qeverimi i gjithë Shqipërisë të merret në dorë prej Komisionit të Kontrollit».

«Dëshira ime mbi këtë pikë u pranua dhe sot kontrollorët u mblodhën, pranuan dhe nënshkruan një protokoll mbi pranimin e propozimit tim, lëshova ushtrimin e pushtetit shtetëror në duart e Fuqive të Mëdha dhe kësioj hoqa dorë nga kryesia e qeverisë kombëtare. Qysh nga shpallja e pavarësisë bëra detyrën patriotike si udhëheqës, ashtu edhe këtë radhë me qëllim të shpëtimit të atdheut, sakrificë që do të bëjë duke u larguar nga kryesia e shtetit për të lënë fatin e atdheut për një kohë të shkurtër në duart mbrojtëse dhe të sigurta të qeverive të mëdha. Jam i sigurt se do të çmohem nga kombi mbarë dhe nga gjithë shokët qeveritarë».

«Ë shoh për detyrë, pra, të deklaroj se kështu e tutje do t'ja kushtoj ditët e fundit të jetës sime, dhe meqenëse, duke marrë në dorëzim qeverimin e adheut tonë, qëllimi i fuqive të mëdha është që si e si t'u japin fund invazioneve të jashtme dhe ngatërresave të brendshme, ju porosis me gjithë zemër që të tregoni bindje të plotë në urdhërat e tyre dhe të funksionarëve të lartë që kanë qenë zgjedhur prej neve dhe të pëlqyer për ta».

«Ju le pra lamtumirën juve, dhe atdhenë e kombin e dashur e lë në mbrojtje të perëndisë!»

Para se të nisej Ismail Qemali, shokët që po e përcillnin i dorëzuan disa dhjetëra napolona të Beledies që t'i përdorte si shpenzime udhëtimi. Ismail Qemali i përshëndeti me këto fjalë: Djemtë e mi, nuk bëra pasuri t'ja lë trashëgim Shqipërisë. Po ju lë një atdhe amanet. Lamtumirë!!».

Nga Vlora Ismail Qemali vajti në Nisë ku desh të çlodhej. Po a mund të çlodhej? Së andejmi ndiqte ngjarjet në Shqipëri; dhe erdhi në Vlorë në verën e vitit 1914 për të ndihmuar në gjendjen e vështirë. Veç se ngjarjet e shëmtuara të vjeshtës 1914 që erdhën me veprimtarinë antikombëtare të Esat Pashës kishin hedhur hijen përpara dhe dukej sikur Shqipërinë po e merrte lumi.

Pas fillimit të Luftës së parë botërore, Ismail Qemali shkoi në Barcelonë, dhe atje priste se ç'fund do të merrnin ngjarjet. Në fillim të vitit 1917 u kthye në Paris, ku i diktoi Mr. Storit «Kujtimet» e tija. Në vështrimin e parë, duke mos njohur mirë jetën e tij, të duket sikur Ismail Qemali, i zhveshur nga ofiqet e tija zyrtare, u hoq mënjanë. Po kjo s'është aspak e vërtetë. Ç'mund të bënte ai, në këtë kohë, në dobi të vendit e bëri, sepse nuk ishte hequr

mënjane, prandaj edhe Partia Politike, e themeluar në Shtetet e Bashkuara, e zgjodhi më 1918 përfaqësues të saj në Konferencën e Paqes.

Kur të mblidhen gjithë sa ka folur e shkruar Ismail Qemali rreth çështjes shqiptare — fjalimet e tija në parlamentin turk, korrespondenca me personalitetet e shquara të huaja e shqiptare, urdhëresat, letrat e raportet gjatë veprimtarisë së tij zyrtare, e thirrjet e bisedat, të gjitha të punuara qartë e bukur me gjithë moshën e tij të shkuar, do të çuditemi me ç'qartësi mendjeje, me ç'stil të bukur i ka shkruar e shprehur Ismail Qemali mendimet e tija.

Po të shikojmë korrespondencën e tij të kësaj kohe, spikat brenga e tij e madhe për fatin e atdheut. Në fillim të vitit 1918, në një letër Ismail Qemali shkruan: «E dini fort mirë se sot për sot për fatkeqësi, Shqipëria ndodhet në atë më të madhin rrezik. Se ky shtet, i gdhendur nga të gjitha anët ashtu si u njoh nga Konferenca e Londrës më 1913, sot, duke qenë i copëtuar nëpër shumë duar të huaja, në ditën e paqes nuk e dimë cilin do të ketë për mbrojtës dhe cili do të jetë miku i vërtetë i Shqipërisë».

Por është edhe më e rëndësishme e vërteta që edhe në ditët e fundit të jetës së tij, Ismail Qemali e kuptoi se bejlerët dhe arhondët qenë armiqtë e Shqipërisë dhe se Shqipërinë që deshë ta krijonte ai vetë mund ta mbronte vetëm vegjëlëia. Le të marrim si testament letrën që na ka mbetur nga ato të fundit, dhe të cilën e ka shkruar vetëm katër ditë para vdekjes: «Sot është dita vendimtare për Shqipërinë: Do të ngjallemi apo do të vdesim. Të kisha marrë të holla do të hidhesha gjer atje për një ma-



Kurora mbi varrin e Ismail Qemalit

rrevëshje të plotë me gjithë atdhetarët e Amerikës. Po pas marrëveshjes me qeverinë, e gjeta të nevojshme të vajturit në Romë. Së andejmi munda të bëja një marrëveshje me gjithë shqiptarët e Shqipërisë për të vendosur veprimin kombëtar në këtë kohë kaq të rrezikshme, dhe t'i japim fund hartimit të programit. Nga Italia kam uzdajë të bëj të nisen prej Shqipërisë së Sipërme, të Mesme e të Poshtme, tre a gjashtë delegatë, të cilët me delegatët e Amerikës të vemi në Paris për t'i propozuar Konferencës kërkesat dhe të drejtat e Shqipërisë...».

«Unë shpresën nuk e kam te bejlerët e te arhondët që kërkojnë të fitojnë të tilla princllëqe. Shpresa ime është në të zotët e opingave, që janë zotët e vërtetë të Shqipërisë. Unë e dua Shqipërinë nën regjim demokrat e federal për popullin shqiptar».

Pas kësaj letre, i thirrur nga qeveria e Romës, ai u nis për në Itali. Në Peruxhia i erdhi urdhëri të priste atje, sepse ata që e kishin ftuar, kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme të Italisë, nuk ndodheshin në kryeqytet. Ismail Qemali, i tronditur nga kjo dredhi, nuk u përmbajt dot dhe thirri: «Më hëngër me të pabesë!» se e kuptoi që e ftuan për ta izoluar në Itali. Etemi, biri i Ismail Qemalit, ja ka treguar kryetarit të Bashkisë, Ali Asllanit, qëndrimin e tyre në Peruxhia kështu: «Një ditë i pregatitën Ismail Qemalit një konferencë për gazetaret. Pas buke, Ismail Qemali hyri në sallonin ku e prisnin korrespondentët. Që në fjalitë e para të bisedës, i zverdhur dhe i lëkundur, nisi të belbëzonte e të mos i lidhte dot fjalët. Kërkoj ta shpinin në odën e banjës. Atje e mbyti shkuma e të vjellët... Ismail Qemali vdiq më 24 janar 1919. Kufomën e mbajtën në Peruxhia edhe nja dy javë që ta «bal-

samosnin» dhe e nisën për në Vlorë më 9 shkurt. Në fakt ja nxuarën gjithë të brendshmet që të mos i linin asnjë shenjë në rast autopsie». Më 28 nëntor 1932, kur u zbulua kufoma në Kaninë që të varrosej në Vlorë, s'i kishte mbetur shenjë balsami dhe qe gjysmë e dekompozuar.

Shtatëdhjetë e pesë vjet jetoi Ismail Qemali, dhe asnjë ditë më pak a më shumë. Dhe nga këta shtatëdhjetë e pesë vjet, vetëm 14 muaj jetoi në atdheun e tij të lirë. Qëkur ish fëmijë e syrgjynosën bashkë me familjen e tij larg Shqipërisë. Edhe ai pati fatin e hidhur të Thimi Mitkos, të Pashko Vasës, Jani Vretos, të vëllezërve Frashëri, e të sa e sa rilindasve të tjerë, të vdesë i syrgjynosur në mërgim. Sa të përshtatshme kumbojnë për Ismail Qemalin vargjet e poetit:

*Syrgjym-gjallë e syrgjym-vdekur,  
Ky vigan Liberator!*

Kur të dihet shkaku i vërtetë i vdekjes së tij, Ismail Qemali do të qëndrojë jo vetëm në krye të shtyllës së pionierëve, por edhe në krye të shtyllës së dëshmorëve të Shqipërisë sonë të Rilindjes.

## P A S F J A L Ë

Herë pas here në shtypin patriotik shqiptar janë bërë kritika, nganjëherë të ashpra jashtë masës, për veprime ose qëndrime të caktuara të Ismail Qemalit. Mirëpo veprimtaria e Ismail Qemalit nuk duhet vlerësuar nga pozitat e asaj kritike që ju bë atëhere, po duhet vlerësuar para së gjithash nga rezultatet përfundimtare të gjithë punës së tij. Detyra dhe qëllimi që i shtroi vetes Ismail Qemali nuk ishin të lehtë. Tepër të vështira e të ndërlikuara ishin edhe rrethanat, në të cilat punoi ai për t'i plotësuar detyrat e për t'ja arritur qëllimit. Në këtë rrugë të gjatë, të vështirë e të ndërlikuar që ndoqi Ismail Qemali, nuk do të kishte pasur burrë që t'u shpëtonte gabimeve. Është për t'u çuditur që Ismail Qemali e mbylli jetën me kaq pak gabime!

Duke u hedhur me pasion e me guxim në valët e bisedimeve, të manevrave e të kombinacioneve të diplomacisë dinake të Evropës, nganjëherë Ismail Qemali harronte të mbështetej aq sa duhej në forcat e gjalla të popullit të tij, që ashtu fjala dhe autoriteti i tij të kishin peshën më të madhe. Por dashuria e flakët për atdheun, përvoja e tij e pasur dhe dituria e tij e gjerë e shpëtuan dhe nuk e lanë

të binte viktimë e prapaskenave aq fort të rrezikshme të diplomacisë dinake evropiane. Pasi e shpëtonte veten nga gjithë dredhirat e kësaj diplomacie, Ismail Qemali përherë e më shumë i afrohej popullit të tij, ja njihte forcën e papërkulur atij populli, dhe mbështetej për herë e më shumë në të. Dhe kështu mund të themi se në dorën e Ismail Qemalit, më 28 Nëntor 1912, ishte përqëndruar forca e vetë popullit shqiptar që ngriti flamurin.

Për një kohë të gjatë Ismail Qemali u shpreh në dobi të autonomisë së Shqipërisë në kuadrin e perandorisë otomane. S'ka dyshim se kërkesa për autonomi gjer në një farë mase e kufizonte vrullin e lëvizjes çlirimtare; por a mos që vërtet ky qëllimi përfundimtar dhe më i tejmi i Ismail Qemalit? Kish-te shumë arsye që e shtynin Ismail Qemalin ta konsideronte për një kohë autonominë e Shqipërisë vetëm si një shkallë drejt pavarësisë së plotë. Pastaj pak më vonë ngjarjet u shtjelluan në një mënyrë të këtillë sa që Ismail Qemali jo vetëm nuk ngurroi të hiqte dorë prej kësaj kërkesë të kufizuar, po në çastin e duhur u bë vetë iniciatori për shpalljen e pavarësisë së plotë të Shqipërisë nga Turqia.

Le të përmendim edhe punën e qeverisë së përkohshme të kryesuar nga Ismail Qemali. Nuk janë të pakta të metat e gabimet në veprimtarinë e saj. Po të gjitha nuk rëndojnë vetëm në supet e Ismail Qemalit. Shumica e këtyre të metave dhe gabimeve rëndojnë mbi përfaqësuesit e bejlerëve dhe të borgjezëve reaksionarë, të cilët, duke mos pasur ndjenja të vërteta kombëtare, jo vetëm më 1912 po sa herë që e deshi interesi i tyre ishin gati të bënin theror interesat e kombit. Këtë tradhëti ata ja punuan Shqipërisë edhe më 1924 edhe më 1939. Sepse



mбетën këto klasa në fuqi, prandaj 28 Nëntori i Ismail Qemalit priti të bashkohej me 29 Nëntorin 1944, që pavarësia e Shqipërisë të bëhej e plotë. Dhe tani, populli ynë, i udhëhequr nga Partia e Punës, në 60-vjetorin e shpalljes së pavarësisë, e kupton dhe e nderon këtë bir të madh të Shqipërisë, Ismail Qemalin, për të cilin bukur ka thënë poeti:

*Emër i tij i vërtetë,  
Është Nëntor 28-të!*

## TRYEZA E LËNDËS

### PJESA I

#### Në shërbim të perandorisë otomane

	Faqe
Hyrje. ....	9
Familja. ....	12
Fëminia. ....	15
Arësimi. ....	19
Fillimi i karrierës politike ....	23
Shtatë vjet syrgjyn ....	28
Në kafazin e florinj të Sulltanit ....	32
Nën shpatën e Damokleut ....	35
Disa përfundime ....	39

### PJESA II

#### Në shërbim të Shqipërisë

Mërgimi i parë ....	45
«Shpëtimi i Shqipërisë» ....	58
Kongresi i xhonturqve ....	61
Përsëri në Turqi ....	66
Mërgimi i dytë ....	72
Në kryengritje të armatosur! ....	79
Drejt 28 Nëntorit ....	88
Dita e lavdishme ....	94
Në krye të qeverisë provizore ....	101
Pasfjalë. ....	115

Tirazhi 8.000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

---

Shtyp. NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»  
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1972